

GJON BUZUKU

Revistë informative, kulturore e shoqërore

Ulqin, e premte më 15 dhjetor 2017 Çmimi 1€

numër 49







Njohje me autorët dhe botimet shqip në Mal të Zi

Shkruan **Ismet Kallaba**

Në sallën "UNESCO" të Muzeut Historik Kombëtar **në Tiranë**, të premten, më 17 nëntor 2017, **janë prezantuar tetë autorë shqiptarë nga Mali i Zi**, për të cilët kanë folur studiues të njohur.



Veprimtaria është organizuar nga Akademia Shqiptare e Arteve dhe e Shkencave, Muzeu Historik Kombëtar, Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Malin e Zi dhe Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave në Mal të Zi.

Në fjalën përshëndetëse, sekretari i ASHASH-it, prof. dr. Marenglen Spiro, ka thënë se ata kanë qenë të informuar me veprimtarinë botuese të shqiptarëve në Mal të Zi nëpërmjet revistave shkencore në gjuhën shqipe që botohen në Mal të Zi, si , "Dija", "Buzuku", "Lemba" dhe "Malësia".

"Ato na kanë lënë një përshtypje të pashlyer si pasqyra të ligjërimit letrar shqip me ngjyrat, veçantitë, pasuritë historike e kulturore të trevave ku jetoni. Ato janë pjesë e pandarë e kulturës sonë, shkencës e komunikimit letrar e shpirtëror, aspekte të jetës të cilat kanë mbajtur gjallë ndër kohëra identitetin e kombit shqiptar", ka thënë ai.

Ndërsa duke folur për prezantimin e tetë autorëve shqiptarë nga Mali i Zi, ai ka thënë se **me këtë veprimtari "shkojmë akoma më tej duke u njohur edhe me vepra të plota letrare të një të sërë krijuesish, pjesëtarë të shoqatës suaj, komentuar në këtë takim nga studiues nga më të njohurit".**

Kryetari i Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi, prim. Dr. Gani Karamanaga, ka thënë se shqiptarët në Mal të Zi kanë nevojë për ndihmën e shtetit shqiptar. "Ne mendojmë se ndihmesa prej Shqipërisë dhe Kosovës për shqiptarët në Mal të Zi duhet të jetë më e madhe", ka thënë ndër të tjera ai.

Për librin e mr. Ali Bardhit "Varrezat në Anë të Malit – Ulqin" ka folur studiuesi dr. Moikom Zeqo, për librin e Ali Dacit "Shtigjet e përgjakura" shkrimtari Sadik Bejko, për përmbedhjen me tregime të Anton Gojçajt "Ndërmjet kapakëve" studiuesja e letërsisë prof. dr. Klara Kodra, për librin e prim. Dr. Gani Karamanagës "Në derë të oborrit" prof. as. Dr. Olimbi Velaj, për librin e Gjekë Gjonajt "Bijtë e shqipes" studiuesi Gjokë Dabaj, për librin e prof. dr. Simë Dobrecit "Krijime popullore shestanese" gjuhëtari prof. dr. Emil Lafe, për librin e akademikut Zuvdija Hoxhiq (Berisha) "Të gjithë të mitë" prof. dr. Xhevat Lloshi dhe për romanet e Mark Lucgjonajt "Fshati i heshtjes" dhe "Ligji i maskave" ka folur studiuesja e letërsisë Ma. Liridona Sinishtaj.

Të pranishmit i kanë përshëndetur edhe Dr. Dorian Koçi, drejtor i Muzeut Historik Kombëtar, dhe Safet Kurtagiq, drejtor i Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave

Përpos autorëve, anëtarëve të ASHASH-it, studiuesve dhe dashamirëve të kulturës, e pranishme në këtë aktivitet ishte edhe Artemis Dralo, zëvendësministre për Evropën dhe Punët e Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

Shih KOHA JAVORE 791, 23 nëntor 2017:28



PËRMBAJTJA

2. Njohje me autorët dhe botimet shqip në Mal të Zi
3. Urime ditëlindjen Nëna Tereza
4. Festa e mërgimtarëve 2017
5. Ditët e Shën Ndout në Braticë
6. Shrimtari i detit magjik
6. Hajro Ulqinaku dhe vendlindja
7. Ndre Durrsaku, profesor i Universitetit të Durrësit
8. Flamuri shqiptar i shekullit XIII
8. Universum Academy Switzerland
9. Shën Gjergji në lumin Buna
10. Vendlindja, Itaka e Krajës, Hoxhiqit dhe Ulqinakut
11. Nderim i veçantë për Stipçeviqin
12. Zëri këndimtar i Shestanit
14. Pjesë nga detaria e Ulqinit
15. Tregime të çuditshme nga Ulqini
16. Katedralja dhe martirizimi i shqiptarëve
18. Politika si arti i qeverisjes
19. Festa e Zojës së Këshillit të Mirë
20. Poezi
21. Ndihmuan Buzukun dhe kishën e Braticës
22. Visar i trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore
23. Vepër e rëndësishme për letërsinë gojore
24. Gruaja e fisit të Shestanit
24. Janullatosi në Shqipëri i huaj dhe armiqsor

GJON BUZUKU 49

REVISTË
INFORMATIVE, KULTURORE
E SHOQËRORE

Kryeredaktor:
Prof. dr. Simë Gjon Dobreci

Zavendës kryeredaktor:
Don Gabriel Grabanica

Ndihmës i kryeredaktorit
Gjekë Gjonaj

Anëtarët e redaksisë:
Dr Martin Berishaj, Dr Nail Draga, Msc Anton Lulgjuraj, Prim.dr. Gani Karamanaga, Dr. Zylfije Duraku, Luigj Camaj, Anton Pllumaj, Gjokë Dabaj, Hajro Ulqinaku, Ali Gjeçbritaj, Muzafer Çaushi, Mustafa Canka

Fotoshërbimi:
Foto Studio Ars, Foto Rozafa, Foto Arb, Art Foto Prishtinë, Foto Bruno
Realizimi artistik:
Fisnik Dobreci & Gazmend Çitaku

Adresa e redaksisë:
Braticë
85360 ULQIN
Nr.tel. ++382 (0) 30 401-384, 069 441-943
www.buzuku.info
E-mail: fdobreci@t-com.me

Numri i llogarisë rrjedhëse
Banka komerciale malazeze A.D.
Ekspozitura Ulqin Nr. 510-0-40
Thirrje ne Nr. 510270393491001825

Me vendimin e Ministrisë të Punëve të Brendshme të Malit të Zi, Podgoricë, nr.05-006/12-20622/2, revista e regjistruar në nr. 6308, më 13.02.2014
Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen

Urime datëlindjen Nëna Tereza

Shkruan **Skender Jashari***



Njerëzimi dhe veçmas Kombi ynë, ka një Nënë, quhet Shenjtja Nënë Tereze!
Simboli i Nënës Shqiptare, i njohur në mbarë botën, për virtyte, të cilat i admiron njerëzimi, tashmë i jep vendin meritor përmes Shenjtës Nënë Tereza! U plotësua Binomi i Figurave Kombëtare, të përbërë nga Gjergj Kastrioti dhe tash nga Nënë Tereza!
Më 26.08.1910 u lind në Shkup të Shqipërisë (pjesë e Vilajetit të Kosovës) nën Perandorinë Osmane!
Kisha Katolike, nuk ka njohur asnjë Shenjte tjetër me emrin Nënë, epitet që sërish gëzon, krenon dhe nderon Kombin Shqiptarë!
Kongregacioni i Misionareve të Bamirësisë, të cilën e themeloi Shenjta Nënë Tereza, në vitin 2012, kishte më tepër se 4500 motra dhe vepronin në 133 vende të botës!
Që për së gjalli e nderoi njerëzimi, për humanizmin e pashoq që bëri, u nderu edhe me çmime ndërkombëtare, si më 1962 me Çmimin e Paqes Ramon Magsaysay dhe më 1979 me Çmimin Nobel për Paqe!
Më 19 tetor 2003, u Lumturua duke u quajtur "Tereza e Bekuar e Kalkutës"! Për t'u kanonizua si Shenjtore, duhej t'i njiheshin dy mrekulli, në bazë të Kishës Katolike, e që mrekullinë e dytë e njohu Papa Françesku, në dhjetor 2015. Kanonizimi i saj u bë më 4 shtator 2016!
Ndërroi jetë më 5 shtator 1997, e që më 5 shtator 2017, do bëhet Shugurimi i Katedrales Shenjtja Nënë Tereza në Prishtinë, nga Kardinali Ernest Troshani!
Në Qiell- tek Krishti, për ne Shqiptarët, ndërmjetëson kjo Shenjte!
Shqiptarët e kemi edhe një Arsye më shumë, që t'a lusim Zotin në Gjuhën tonë Shqipe!

***Skender Jashari** i burgosur politik nga EULEX, për rastet e sulmeve kundër policisë dhe xhandarmërisë së Serbisë në Dobrosin komuna e Bujanocit. Ky shkrim është pjesë e marrë nga punimi i bërë gjatë qëndrimit në burgimin politik! Master drejtimi juridiko-penal dhe studime joformale ushtarake.
Datum: 26.08.2017 12:53 Od: Kosova Lindore gj.shqiperia1@gmail.com Za: fdobreci@t-com.me, Përshendetje i/e nderuar!
Me rastin e ditëlindjes së Shenjtës Nënë Tereze, si ditë e rëndësishme për çdo Shqiptar, nëse e shihni të arsyeshme ju lutem ta publikoni. Me respekt **Skender Jashari**!

FESTA E MËRGIMTARËVE 2017

Shkruan: Izabella Pepgjonaj

Natën e 29 korrikut 2017, Kisha Katolike e Ulqinit i bashkoi për të tetin vit me radhë të gjithë mërgimtarët të cilët vendosën që pushimet verore t'i kalojnë në vendlindjen e të parëve të tyre.

Tashmë jemi të informuar të gjithë për festën e mërgimtarëve dhe rolin që ajo ka.

Është thjeshtë një festë falënderuese ndaj njerëzve të cilët i përkrahin aktivitetet e kishës katolike në të gjitha aspektet; përkrahje morale e financiare. Kështu që ne si kishë mundohemi t'i falënderojmë për kontributin e tyre me anë të një feste sikur është kjo. Gjithashtu, kjo festë ka për qëllim që t'i bashkojë mërgimtarët duke pasur para sysh se ata janë shkëputur nga vendlindja e të parëve të tyre për të kërkuar kushte më të mira jetësore.

Me fillim në orën 19, në plazhin "Bukuria e Ulqinit" u bashkuam të gjithë; mërgimtarë e besimtarë të famullive të Ulqinit, si edhe mysafirë të tjerë të ardhur nga Shqipëria e Kosova. Nuk mungoi as prezenca e Mons. Rrok Gjonlleshaj, Argjipeshkvit të Tivarit, të cilin e falënderojmë përzemërsisht që është gjithmonë përkrahës i aktiviteteve tona.

Ajo çka e bëri edhe më të veçantë këtë natë është programi i përgatitur nga Ansambli i Gjakovës. Edhe ansamblin në krye me koreografin z. Memli Dolin e falënderojmë që për çdo festë na hijeshojnë skenën me vallet e tyre. Duhet përmendur edhe paraqitja e këngëtares Leonora Rugova e cila me këngët e saja preki zemrat e shumicës prej nesh.



Shije të veçantë kësaj nate i dhanë edhe rinia me veshjet kombëtare shumëngjyrëshe që qëndronin në shtatin e e tyre, duke filluar nga gërsheti i shestaneshës e duke përfunduar tek xhubleta e malësores. Pjesë e programit ishin edhe paraqitja e aktiviteteve vjetore të kishës me anë të disa fotografive dhe filmimeve, si edhe darka modeste e përgatitur nga rinia.

Vitin e kaluar kemi thënë se kemi pasur një vit Hiri me shumë dhurata nga Krijuesi, duke filluar nga shugurimi i Argjipeshkvit të ri e duke vazhduar tek Shenjtërimi i Nënës Terezë. Por edhe për këtë vit mund të themi se kemi përjetuar shumë ngjarje të rëndësishme, një prej tyre edhe kushtimi i Katedrales së Tivarit dhe kishës në Prishtinë, ngjarje të cilat sa e sa njerëz i kanë pritur por nuk e kanë pasur mundësinë t'i përjetojnë. E ne i jemi falënderues Zotit që na e dha këtë mundësi. E një falënderim i veçantë i shkon mërgimtarëve të cilët financiarisht kanë mundësuar rregullimin e këtyre objekteve dhe shumë projekte tjera që janë të dukshme në vendin ku ne jetojmë.

Unë si moderatore e programit, e vlerësoj këtë festë pozitivisht dhe mendoj që ishte shumë e bukur për të gjithë ne. Gjithashtu, në emër të kishës falënderoj të gjithë pjesëmarrësit dhe atyre mërgimtarëve të cilët kanë ardhë për të pushuar në tokën e tyre ju dëshiroj pushime sa më të këndshme. Shpresoj të takohemi edhe vitin e ardhshëm në të njëjtën ngjarje e të festojmë së bashku.

Ma mirë nji qyme pushtet se nji çiflig (tha dynjallëku).

*

Dy t'kqi vrasin nji dai (tha plaku)

*

Qentë lehin, karvani ecën (popullore)



Ditët e Shën Ndout në Braticë

Shkruan **Luigj Camaj**



Manifestim tradicional i cili i kushtohet Shën Ndout u organizua në Braticë, qershor 2017. Manifestimi është thjeshtë meritë e zotëri Don Gabriel Grabanica, famullitarë në Famullinë e Braticës dhe donatorëve vendor të shumët të cilët me vazhdimësi e mbështesin këtë aktivitet fetar, kulturor, kombëtar dhe edukativ.

Në kuadër të këtij manifestimi janë organizua aktivitete të ndryshme si vizita e monumenteve të shumta të trashëgimisë kulturore e historike të Komunës së Ulqinit dhe të Malësisë.

Po ashtu ky manifestim është rast i mire i takimeve me njerëzit tone nga diaspora dhe shoqërimeve mesë besimtarëve dhe njerëzve të vullnetit të mirë. Manifestimi u mbajt më 9, 10 dhe 11 qershor 2017.

Dita e parë iu kushtua vizitës së destinacioneve turistike të Ulqinit nën udhëheqjen e Mr. Anton Lulgjutaj. Me këtë rast vëllezërit tonë nga Kalabria vizituan Kalanë e Ulqinit dhe muzeumin e Kalasë, qytetin antikë e mesjetarë të Shasit dhe destinacione të tjera me rëndësi në komunën e Ulqinit.

Dita e dytë ishte e rezervuar për vizitë të pikave më të rëndësishme kulturore e historike të Malësisë nën përkujdesjen e OJQ LABEATËT.

Ditën e dytë Shoqata "Shkëmbi" nga vendi Acuaformosa e Kalabrisë, Itali vizitoi Malësinë.

Për ti gostitur miqtë nga Kalabria u përkujdes OJQ "LABEATËT" me sponsorët Vasel Gjergj Dedvukaj dhe Zef Xho Camaj. Pritja e vëllezërve tone nga Kalabria u bë në barkën LIRIA në ujërat e liqenit të Labeatëve (Shkodrës). Kjo ishte hera e pare që shoqata "Shkëmbi" vizitoi trojet shqiptare në Mal të Zi. Shoqata "Shkëmbi" është formuar dhe vepron me qëllimin e ruajtjes së trashëgimisë kulturore e historike të arbëreshëve që jetojnë në vendbanimin arbëresh Acuaformosa dhë më gjerë në Kalabri të Italisë. Ishte privilegj i veçantë që "LABEATËT" në mbështetjen e zotëri Don Gabriel Grabanica dhe donatorëve Vaselit dhe Zefit të gostisim miqtë nga Kalabria. Që "LABEATËT" ta prezantojnë Malësinë dhe vlerat e saja natyrore gjeografike dhe kulturore historike në mënyrë sa më të denjë të përgatitën një guide turistike. Guida përmbante vizitën e Muzeut Etnografik, fototekës, bibliotekës dhe filatelisë në fshatin Lekaj të pronari t'Shtjefën Ivezaj. Me këtë rast u vizituan edhe Shtëpia-Muze e Dedë Gjon Lulit, kisha mesjetare në Qafë të Kishës, vorrezat monumentale në Vuksanlekaj, Kroi i Traboinit dhe liqeni I Labeatëve (Shkodrës).

Dita e tretë: Që Bratica të jehojë dhe zëri ti shkojë sa më larg organizatori ftoi shoqëritë kulturore artistike: "Shkembi" nga Acuaformosa e Kalabrisë, Grupin "Rinia" nga Rragami (Shkodër) dhe "Trendafilat e Shën Terezes" (Ulqin). Artistët e këtyre shoqërive kulturore me tingujt e instrumenteve, më zërin e tyre artistik dhe me paraqitjet folklorike kënaqën shikuesit të cilët me kujdes përcillnin çdo pike artistike të ekzekutuar me kujdes të madh.

Ky aktivitet u mbajt natën e fundit në qendrën e Braticës mbas celebrimit të Meshës Shenjte.

Shtëpiakët nga Bratica në mënyrë tradicionale si shumë herëve të tjera treguan mikpritjen burrërore duke gostitur të gjithë të pranishmit me ushqime tradicionale të përgatitura me kujdes të madh me duar të shestaneshave.

Shoqata "Shkëmbi" këtë here ishte mike e Famullisë së Braticës me anëtarët: Nicola Mele, Paola Napolitano, Filomena Skorza, Cesare Vicchio, Rosa Cirillo, Capparelli Domenico dhe Sandra De Angelis në udhëheqjen e Drejtorit Pirro Qendro. Ishte privilegj që drejtpërdrejt t'i dëgjojnë tingujt e gjuhës arbëreshe dhe gjuhës të cilën fliste vetë Gjergj Kastrioti. Gjuhë të cilën me sakrifica të shumta dhe përkushtime e ruajtën arbëreshët ndër shekuj dhe me kujdes të madh e përcollën në trashëgimtarët e tyre.

Arbëreshët dhe gjuha arbëreshe e cila ende është e gjallë janë shembulli më i mire i patriotizmit, përkushtimit ndaj kombit, kulturës, traditës dhe trashëgimisë e përcjellë deri në ditët e sotme. Prandaj diaspora jonë dhe jo vetëm diaspora ta përcjellin shembullin e arbëreshëve të Kalabrisë.

U ndamë me miqtë tonë të shtrenjtë në orët e vona të natës së të shtunës duke shpresuar se kjo vizitë nuk do të jetë vizita e fundit e "Shkëmbit" në Malësi dhe se miqësia me kalabrezët do të vazhdojnë me vizita të ndërsjellta.

> Medicus curat, natura sanat (Mjeku mjekon, natyra shëron, *latine*).



Shkrimtari i detit magjik

Shkruan **Ismet Kallaba**



Hajro Ulqinaku, Zëri i detit, BKSHMZ, Ulqin, 2017.

Me rastin e 60-vjetorit të krijimtarisë së tij letrare, shkrimtari Hajro Ulqinaku vjen me një libër të ri, të cilin e ka titulluar "Zëri i detit". Në te ai ka përmbledhur krijimet e tij letrare, duke filluar që me tregimin e parë, në vitin 1957, e deri në ditët e sotme, të cilat janë botuar më herët në periodikë të ndryshëm në Prishtinë, Shkup, Podgoricë e Ulqin.

Siç thotë vetë autori, në parafjalën e librit, "ky vëllim është sajuar me krijime të tre, saktësisht, të katër gjinive letrare dhe të trajtave, formave të veçanta krijuese: monodramë, skenar, libret; artikuj analitikë-studimorë; fjalë të urta për detin etj."

Kryefjalë edhe e këtij libri është deti me të gjitha përmasat e tij, për të cilin shkrimtari është aq shumë i lidhur, duke fituar edhe epitetin e shkrimtarit të detit magjik.

Libri është botuar nga Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi, me mbështetjen e Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave, ndërsa është shtypur në shtypshkronjën "Press Studio" - Ulqin.

Redaktor i librit është Asllan Bisha, recensentë Sulejman Dërmaku dhe Sabit Jaha, redaktor artistik Qazim Muja, kurse ballina është punuar nga piktori Agron Ujkashi dhe autori.

Përurimi i librit u bë të martën mbrëma më 26.09.2017 në Bibliotekën e Ulqinit, në organizim të Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi dhe Qendrës së Kulturës – Bibliotekës në Ulqin.

Shih KOHA JAVORE nr 783, më 28 shtator 2017:24.

Hajro Ulqinaku dhe vendlindja

Shkruan Prim.Dr.Gani Karamanaga

Hajro Ulqinaku studimet e albanologjisë i kryen në Fakultetin filologjik të Beogradit në vitet 1959-1963 ku shoqërohet fillimisht me *Simë Dobrecin, Shefket-Kusho Dollakun* e më vonë edhe me *Shuajb Resulbegun*. Në ato kohëra Beogradi si kryeqendra e ish Jugosllavisë ishte qytet i lirë, i hapur për çdokend. ***Kthimi i parë në vendlindje*** është në vitin 1978 kur punonë një vit në Krajë. Nxënësit e tij atëherë ishin*: Hajrullah Koliqi, Ibrahim Berjashji, Nazire Curaj, Hajrullah Hajdari*. Por, vendlindja të cilën e kishte në shpirt dhe në zemër ja japi letrën për Kosovë. Më së pari , në Kosovë punoj e jetoj në Ferizaj ku nxënësit e tij ishin: *Mehmet Bardhi, Ibrahim Berjashi, Nazire Curaj*. Mandej është periudha e jetesës dhe punësimit në Prishtinë ku punonte si gazetar, redaktor në TV. Ishte koha e krijimtarisë së tij, ku bëhet njëri prej shkrimtarëve më të njohur për fëmijë shqiptar. Edhe në këtë krijimtari dominojnë motivet e detit, krejtësisht të vendlindjes.

Kthimi i dytë në Ulqin. Dhe kështu deri në vitet e nëntëdhjeta kur mbeti pa punë. Si shumë patriot tjerë vazhdon dhe mbijeton deri në vitin 1999 duke bërë rezistencë pushtetit sërbomadhë kur vjenë të jetoj përësëri në vendlindje –Ulqin. Ishte *kthimi i dytë në Ulqin*. Prej atëherë në muajtë e pranverës, verës dhe fillimin e vjeshtës ishte në Ulqin, kurse dimrit shkonte në Prishtinë.

Revista " Kronika ". Prej vitit 1999-2001 angazhohet si kryredaktor, dhe gazetar i " Kronikës ". Pronar ishin *Ilir Çapuni* dhe *Gazmend Çitaku.* "Kronika" në ato vite ishte dritare e hapur për shumë autorë shqiptarë. Lujti rolin e madhë për të njohtuar opinionin për problemet lidhur me Xhaminë e Ranës. Gjithashtu ka shkruar dhe afirmuar mundësitë e ndërtimit të maternitetit në Ulqin.



Themelimi i Bashkmimit të krijuesëve shqiptarë në Malin e Zi. Hajro Ulqinaku ishte në Këshillin nismëtar për themelimin e BKSHMZ më 22 nëntor 2002.

Revista " Dija" . Hajro Ulqinaku ka qenë kryeredaktori i shumicës së numërave të Dijes. Deri tani kanë dal nga shtypi 15 numra të "Dijes". Një numër është që kanë qenë kryredaktor *Muamed Nika, Prof. Simë Dobreci, Gjekë Gjonaj dhe së bashku Gazmend Çitaku dhe Dr. Gani Karamanaga.* Dhe për të gjithë dhjetë numrat tjerë ishte kryredaktor Hajroja. ***Krijimtaria për peshkatarë dhe detarë.*** Këtë periudhë e karakterizon krijamtaria e frytshme. Hajro Uqinaku duke u shoqëruar në Ranë me bashkëvendësitë e tij shkruan dhe publikon disa libra për detarë dhe peshkatarë Ulqinak. Personazhet në librat e Hajros janë njërëzit e çdoditshëm, të cilët lundruan nëpër detet e afërme dhe nëpër oqeane, peshkatarët me famë, njërëzit të cilët ruajtën folklorin e Ulqinit. Një ditë Hajros dikush i tha :

" Pse ke shkru për Osman Leskovcin? "

„ Osmani ka rujtuar folklorin e Ulqinit, shumë njërëz tjerë do të harrohen, por Osmani do të mbet si ulqinak i cili këndon dhe kultivon kangët e vjetëra ulqinake" ishte përgjigja e Hajros.

Ndihmesa e krijuesve-shkrimtarëve. Hajro Ulqinaku ka qenë redaktori, konsulenti dhe lektori i disa autorve nga Ulqini dhe Malësia-Tuzi. Duke redaktuar dhe lektoruar librat e tyre ai njëkohësisht ishte edhe drejtuesi dhe ndihmesë e madhë për këto krijues. Po i numroj disa prej tyre

(Nga përurimi i librit „ Zëri i detit))

Ndre Durrsaku, profesor i Universitetit të Durrësit

Shkruan prof. Dr Jahja Drançolli, Fakulteti Filozofik, Prishtinë

Burime që dalin nga arkivat dhe bibliotekat e Kuvendit Françeskan dhe Kuvendit Dominkan në Dubrovnik, përveç njoftimeve të rëndësishsme për historinë tonë të moçme, ofrojnë edhe njoftime për të parin universitet në Ballkan, Universitetin e Durrësit ("Studium generale", në vitet '80, të shek. XIV), universitet ky i themeluar nga dominikanët durrsakë, që vepronin ç'prej vitit 1224 në Kuvendin e Shën Maurit në Durrës. Nga burimet që fshihen në arkiva dhe biblioteka të përmendura më sipër bëhet e njohur se, sukseset osmane në Betejën e Savrës (1385), kishin shkaktuar frikë edhe te profesorët e Universitetit të Durrësit, një pjesë e të cilëve do të detyrohen ta braktisnin vendlindjen për tu ngulitur sidomos në qendra të Dalmacisë dhe Italisë. Me vete kishin bartur edhe fonde me dorëshkrime të pasura me miniatura, të cilat gjatë shek. XV janë vendosur në Bibliotekën e Kuvendit Dominikan në Split, si dhe në Bibliotekën e Kuvendit Dominikan në Braç (Kroaci). Tashmë është e njohur se profesori, Gjon Durrsaku kishte vajtur në Zarë, dhe atje ishte caktuar për rektorin e parë të Universitetit të Zarës (1396). Ndërsa, Ndre Durrsaku (mesi shek. XIV-13 qershor 1393), një profesor tjetër i Universitetit të Durrësit, që po zbulohet rishtazi, i njohur edhe si doktor i shkencave teologjike (Universiteti i Bolonjës, 1380), në vitin 1387, qe emëruar për arqipeshkëv të Arqipeshkvisë së Raguzës (Dubrovnikut)!



Burimi: Mbishkrimi epigrafik dhe busti e Ndre Durrsakut në Kuvendin Dominikan të Dubrovnikut (foto e realizuar më 20/10/2017).

Flamuri shqiptar i shekullit XIII

Shkruan prof. Dr Jahja Drançolli, Fakulteti Filozofik, Prishtinë

Flamuri dhe stema arbërore sipas burimeve historike të shek. XIII konsiderohen për më të moçmet në Ballkan!

Pas themelimit të Perandorisë Latine në vitin 1204 nga Republika e Venedikut, mbretëria e Francës, e ndonjë vendi tjetër europian, shteti i Arbërit, Epirit dhe Moresë (sikurse që kishte vepruar më parë mbretëria e Kroacisë në vitin 1102 me mbretërinë e Hungarisë), do të kërkojnë mbrojtje nga bujaria e shteteve në fjalë, të cilat kishin sjellur në Arbëri edhe traditën europiane të heraldikës. Derisa, sipas traktatit në Viterbo të Italisë (1267), Epiri dhe Morea do të inkuadrohën nën mbrojtjen e Karlit I Anzhuin, këtë veprim do ta parapelqejnë edhe kryezotërinjtë arbër në vitin 1272, vit ky që përkon edhe me themelimin e Mbretërisë së Arbërit (De Regnum Albaniae) në krye me Karlin I (Rex Albaniae), me seli në Durrës. Në këtë kontekst, hereladika arbërore, e cila ruante simbolikën, që nga kohët më të hershsme të qytetërimeve të Mediteranit, fuqishëm do inkuadrohet në rrjedhat e mëtejshme të Europës Perëndimore, në veçanti të shteteve italiane të kohës. Kjo traditë e pasur euro-piane do të manifestohet sidomos te heraldika e familjeve të njohura arbërore, si, bie, fjala te kastriotët, dukagjinët, të cilët zotëronin edhe me Rrafshin e Dukagjinit dhe trevën e Prizrenit së bashku me qytetin.


Flamuri i Familjës Kastriroti në kuadër të afreskave të Katedralës Zoja Sh'Prene në Prizren!

Vendosja e pushtetit osman do ta ndalon këtë proces të trashëgimisë tonë të pasur, e cila do të vazhdon sërish vetëm nga 28 Nëntori i vitit 1912!

UNIVERSUM ACADEMY SWITZERLAND

Universum Academy Switzerland, është themeluar në vitin 1990 në Bellizona të Zvicrës ku edhe është regjistruar në bazë të ligjeve të këtij vendi. Me qendër në Llugano kjo Organizatë që nga viti 2013 është pjesë e Regjistrit të BE si dhe e Kombeve të Bashkuara që nga viti 2014. Themelues dhe kryetar aktual është Dr. Valerio Giovanni Ruberto.
Misioni i Universum Academy është promovimi i kulturës, historisë dhe traditës së popujve. Në bazë të nenit 31 të Statutit, Universum Academy mbështet **International University of Peace** e cila merret me afirmimin e vlerave absolute siç janë Jeta, Familja, Të drejtat e njeriut, Paqja në mes njerëzve.
Gjithashtu nën mbështetjen e Universum Academy organizohen ***Universum International Literary Award***, një konkurs letrar me karakter ndërkombëtar i përcjellë me Çmim Ndërkombëtar, ***Universum Donna, Alexander*** dhe ***Universum Medical and Scientific Research Award*** të cilat për çdo vit ndajnë çmime për arritje meritore akademike, kërkime shkencore, gazetari dhe fushat e ndryshme shoqërore.
Kjo organizatë përveç rrjetës së vet në Zvicër dhe Itali degët e saja përmes Ambasadorëve të saj përfaqësohet edhe në një numër të madh shtetesh si: SHBA, Kanadë, Portugali, Spanjë, Angli, Shqipëri, Greqi, Kroaci, Serbi etj së fundmi Ambasador i kësaj Shoqate për Malin e Zi u zgjodh **z. Gazmend Çitaku** nga **Ulqini.** Me një mandat tre vjeçar Gazmendi do përfaqësoj interesat e kësaj Shoqate në Malin e Zi. Akreditimi solemn dhe ceremonia e inaugurimit Ambasador u mbajt më 14 tetor 2017 në Montsilvano të Italisë. Kjo ceremoni u zhvillua nën praninë e një numri të madh të përfaqësuesve të jetës akademike e kulturore Italiane e përcjellë me performansa të ndryshme muzikore, aktrimi dhe pika baleti.



Në ceremoninë e njejtë përveç akreditimit të Ambasadorëve të shteteve u ndanë edhe çmimet për Ambasadorë paqe, Çmimi për kontributin e femrës në jetën shoqërore, Çmimet për kërkime dhe arritje shkencore si dhe Çmimet stimuluese për krijuesit e rinj prej moshës 18-30 vjeçare.

Redaksia Gjon Buzuku

Shën Gjergji në lumin Buna

Shkruan **Msc Anton Lulgjuraj**

Fshati Shën Gjergj ndodhet 15 km larg në verilindje nga qyteti i Ulqinit, në bregun e djathtë të lumit Buna, pranë vijës kufitare në mes Malit të Zi me Shqipërinë. Fshati ngrihet në rrënxën lindore të Malit të Brisë, i cili përfundon në lumin Buna i rrethuar nga një ambient i bukur natyror. Përreth kishës në rrënxën e malit ngrihet fshati në një lartësi më të madhe mbi detar. Kjo për arsye te lagështisë dhe përmbytjeve që në të kaluarën e afërt ishin të shpeshta sidomos me ngritjen e nivelit të lumit Buna në gjysmën e shek. XIX.



Kisha e Shën Gjergjit, prej të cilit shenjtor edhe fshati e ka marrë emrin, ndodhet në qendër të fshatit, në fushën aluviale të formuar prej shumë kohësh më parë nga prurjet e lumit Drin dhe Buna.

Më së pari fshati është paraqitur në hartat e Coronellit për Dalmacinë lindore (Coronelli, Carta Dalmazia). Ndërsa në dokumentet historike emri i fshatit përmendet nga Marin Bici në vitin 1610. Ai tregon se fshati atëherë kishte 30 shtëpi, të ritit katolik me kishën e Shën Gjergjit e cila ishte shumë e vogël dhe e bukur. Me mure të piktura në afresk të shënjtorëve dhe sidomos të Shën Mërisë mbi altar, dyshemenë të pa niveluar me varre. Në krahasim me Bicin, pak më vonë Bolica tregon se fshati kishte vetëm 20 shtëpi me kryetar të vetin Marin Kolën. Në shek. XVIII sipas dëshmive arkivore të përgatitura nga Zmajeviqi, del se kisha në fshat ishte e zbuluar.

Sot ruhet mirë kisha bashkë me varreza dhe është funksionale për komunitetin katolik vendas. Sipas dëshmive të njerëzve të vjetër, kisha e vjetër ishte më e vogël se kisha e sotme dhe mbi të është ndërtuar dhe rindërtuar kisha e sotme. Sipas të dhënave të kishës, ajo është rindërtuar rreth vitit 1927 nga misionari Alberto Esposito. Dëmtohet përsëri nga termetët katastrofale të vitit 1968 dhe 1979, riparohet përsëri dhe sot është kishë funksionale.

Kisha është e rrethuar me varre të reja dhe të vjetra. Ato të vjetrat spikasin me larmin e simboleve si: diellit, hënës dhe figurës njerëzore. Këto varre me këto simbolika janë të gjitha karakteristike për Shqiptaret e veriut të Shk. XVIII-XIX. Po ashtu në anën e djathtë të portës kryesore ndodhët varri i famullitarit të Shën Gjergjit, Zef Ashta (+1874) i shkruar në gjuhën shqipe.

Në fshat sot egzistojnë toponime të ndryshme që dëshmojnë lashtësi dhe që kanë lidhje me vendbanimin mesjetar dhe me kishën. Gjurmë rrugësh ka në lokalitetin e quajtur Vau i Shnjergjit që ndodhet rreth 100 m. në jug të kishës dhe të urës në lokalitetin "Vija e Shnjergjit", që ndodhët rreth 1 km. më në veri. Duket se këndej kalonte rruga mesjetare që ishte edhe rruga kryesore që lidhte qytetin e Ulqinit me Shkodrën. Ajo kalonte përmes këtij fshatit dhe vazhdonte përgjatë lumit Buna në drejtim të fshatrave Fraskanjel dhe Belaj.

Pra fshati i Shnjergjit ka luajtur një rrol të rëndësishëm në historinë mesjetare të rrethinës së Ulqinit, duke ju falënderuar pozicionit të mirë pranë lumit Buna e cila ishte edhe porta e Shqipërise Veriore për në det por edhe në aspektin religjioz, për të cilën dëshmojnë burimet histrorike dhe kisha e bukur.



Vendlindja, Itaka e Krajës, Hoxhiqit dhe Ulqinakut

Shkruan **Ismet Kallaba**

Në kuadër të Panairit të Librit në Ulqin, më 18.08.2017, në Bibliotekën e Qytetit në Ulqin është mbajtur mbrëmja letrare e titulluar "Tre shkrimtarë dhe vendlindja" kushtuar shkrimtarëve Mehmet Kraja (akademik), Zuvdija Hoxhiq – Berisha (akademik) dhe Hajro Ulqinaku.

Udhëheqësja e Bibliotekës së Ulqinit, Ardita Rama, njëkohësisht moderatore e mbrëmjes, ka treguar se janë përcaktuar për temën e vendlindjes pasi që roli i saj në zhvillimin e identitetit është shumë i rëndësishëm nga shumë aspekte.

"Rrethi në të cilin lindin e jetojnë ndikon në formësimin e karakterit dhe mentalitetit, çka doemos pasqyrohet gjatë jetës e posaçërisht këtë ndikim e hasim në letërsi", është shprehur ajo, duke shtuar se tre shkrimtarët ngjarjet në veprat e tyre i vendosin pikërisht në vendlindje.

Disa reflekse për temën e vendlindjes në veprat e shkrimtarëve Mehmet Kraja, Zuvdija Hoxhiq – Berisha dhe Hajro Ulqinaku, i ka paraqitur në esenë e tij studiuesi i letërsisë mr. Haxhi Shabani.

Ai ka thënë se "**pikërisht vendi që ata do t'i japin vendlindjes në krijimtarinë e tyre, qoftë si nocion, shprehje, mendësi, ndjeshmëri, gjuhë, kolorit, stil etj. do të jetë i shumanshëm**".

Sipas Shabanit, **shkrimtarët Mehmet Kraja, Hajro Ulqinaku dhe Zuvdija Hoxhiqi jo vetëm me veprën e tyre, por me mbiemrat e tyre dëshmojnë për lidhjen e tyre të gjithanshme me vendlindjen.**

"Sa i përket shkrimtarit Mehmet Kraja, mund të thuhet me siguri se nëse renditen romancierët më të mirë të letërsisë shqipe të cilët mund të numërohen brenda gishtave të një dore: shkrimtari Mehmet Kraja është gishti tregues, referencial e model për nga cilësia dhe sasia që në prozën shqipe dhe më gjerë. Si për analogji edhe shkrimtari Hajro Ulqinaku në letërsinë shqipe për fëmijë është ndër shkrimtarët më shquar, sikurse edhe shkrimtari Zuvdija Hoxhiq-Berisha ndër prozatorët më të mirë në letërsinë që shkruhet në Malin e Zi", ka thënë ai.

Vetë shkrimtarët kanë pranuar se vendlindja ka pasur ndikim të madh në krijimtarinë e tyre, nga ku e kanë marrë brumin, lëndën e parë për veprat e tyre.

Shkrimtari Mehmet Kraja ka thënë se "tema e vendlindjes në rastin e letërsisë është e pakalueshme sepse njeriu është pjesë e mbamendjes, vendlindja është pjesë e memorjes. Nuk mund të lirohet njeriu nga memorja e tij".

Ai ka potencuar rëndësinë që ka gjuha në bërjen letërsi, duke thënë se jashtë gjuhës nuk ka asgjë në letërsi.

"Kjo magji e gjuhës për mua ka qenë sfida më e madhe letrare. Për mua ka qenë e jashtëzakonshme ajo që realisht e gjeja në gjuhën e një pjese të Krajës", është shprehur Kraja.

Duke folur për personazhet e veprave të tij, që vazhdimisht janë nga vendlindja, akademiku ka thënë se kjo nuk ka të bëjë me kurrfarë realizmi magjik, por se personazhet e tij janë magjikë vetë.

Akademiku tjetër, shkrimtari Zuvdija Hoxhiq – Berisha ka thënë se thonë që nuk ka shkrimtarë pa vendlindje, por që "për fat të keq, ka vendlindje pa shkrimtarë".

Ai ka thënë se ka pasur fatin që të lindi në një vend si Gucia, e cila ka vërtet një fuqi magjike për të bërë për vete.

"Rrethanë me fat është se historia, fati, këtë mjedis e ka bërë shumë interesant, dhunti për të shkruar. Më besoni, unë nuk kam pasur nevojë të imagjinoj asgjë. Personazhet e mi janë realë, njerëzit për të cilët shkruaj janë realë", është shprehur ndër të tjera Hoxhiq.

Ndërsa shkrimtari Hajro Ulqinaku e ka quajtur vendlindjen "një mrekulli, të cilën mund ta përjetojë vetëm ai që nuk ka jetuar në vendlindje ose ka qenë i privuar nga e drejta që të jetojë në vendlindje".

Duke përkujtuar thënien latine se "ku e ke mirë, aty e ke atdheun", ai ka thënë se "nuk është krejt ashtu sepse guri i rëndë peshon megjithatë në vendin e vet".


"Unë falë Zotit jam kthyer në Itakën time. Ulqini është Itaka ime dhe jam kthyer në Ulqin. Ulqinin e kam pasur gjithmonë në mendje, në zemër. Dhe çdo gjë që kam krijuar, prej letërsisë për fëmijë deri te librat dokumentarë, e kam pasur Ulqinin temë", ka thënë Ulqinaku.

Shih KOHA JAVORE 778, 24 gusht 2017:14.



NDERIM I VEÇANTË PËR STIPÇEVIQIT

Shkruan: **Mehmet Latifi,** Strugë, Maqedoni



Universiteti "ILIRIA" në nderim të Aleksandër Stipçeviqit ndanë çmimin dhe themelon Institutin për hulumtime ilirologjike me emrin e tij.

Këshilli mësimoro-shkencor i Universitetit-Kolegjit "ILIRIA" në Prishtinë, ka sjellë dy vendime të rëndësishme, me të cilët shprehë respektin dhe mirënjohjen e veçantë ndaj Akademikut të ndjerë, Aleksandër Stipçeviqit, arkeologut, albanologut, ballkanologut, historianit, bibliografit-shkencëtarit me famë botërore, i lindur në Arbënesh të Zarës (lagje e Zarës e banuar me arbënesh-shqiptar, që nga vitet 1726).

Në njoftimin e Kolegjit "Iliria" të nënshkruar nga Presidenti i këtij institucioni të lartë arsimor, prof. Dr. Mixhait Reçi, bëhet e ditur se: "Duke marrë parasysh bashkëpunimin e shkencëtarit me famë botërore me Kolegjin "Iliria" dhe me synim të ngritjes së nivelit mësimor-shkencor të Kolegjit "Iliria", ka miratuar propozimin e Presidentit prof. Dr. Mixhait Reçi dhe Këshillit mësimor-shkencor (Senatit) të Kolegjit "Iliria" për themelimin e Institutit për Hulumtime Ilirologjike me emrin "Aleksandër Stipçeviq".

Instituti për Hulumtime Ilirologjike do të tërheq shkencëtarët e fushave përkatëse, do të formojë një data-bazë të të gjitha punimeve si dhe do të formojë një bibliotekë të pasur nga fusha e ilirologjisë, për të joshë dhe për të nxitur shkencëtarët e rinj që të merren me hulumtime të tilla. Po ashtu, do të organizojë edhe tryeza shkencore nga tematika e ilirologjisë.

Krahas këtij vendimi, Këshilli mësimor-shkencor (Senati) ka miratuar edhe propozimin tjetër të Presidentit, të Kolegjit "Iliria", prof. Dr. Mixhait Reçi, për ndarjen e çmimit ndërkombëtar shkencor, që mban emrin e Akademik Aleksandër Stipçeviqit, çmim që do t'u ndahet personaliteteve të shquara të botës akademike-shkencore për kontributin dhe arritjet e tyre shkencore, në publicistikë si dhe për projektet nga fushat e ndryshme shkencore dhe hulumtuese.

Akademik Aleksandër Stipçeviqi, pjesën më të madhe të veprimtarisë së tij e ka zhvilluar në Zagreb, ku ka punua në Bibliotekën Kombëtare dhe atë Universitare, pastaj në Entin Leksikografik "Mirosllav Krlezha", dhe pas vitit 1987 në Fakultetin Filozofik, ku ligjëruar në Degën e Shkencave të Informacionit. Ai po ashtu ka qenë ligjërues edhe në Universitetin e Prishtinës. Është autor i shumë punimeve shkencore, ndër të cilat veçohet libri "Ilirët, historia, jeta, kultura" nga viti 1974, që ka përjetuar 7 ribotime në gjuhën shqipe dhe është përkthyer në shumë gjuhë të botës.

Ceremonia e ndarjes së çmimit "Aleksandër Stipçeviq" do të zhvillohet në Prishtinë, në ambientet e Kolegjit "Iliria" më 10 tetor 2017, në 87 vjetorin e lindjes së Akademik Aleksandër Stipçeviqi.



Në fotografi Aleksandër Stipçeviqi me Idriz Ajetin, më 06.04.2009

Zef Chiaramonte* shkruan: "Arbëreshët - Shqiptarë nga gluha, Bizantinë nga tradita kishtare, Italjanë nga adoptimi".

Edhe don Gjon Buzuku në "Mesharin" e tij të botuar më 1555 përdoron fjalën *gluha* në vend *gjuha*, si thuhet sot.

*Prof. Zef Giuseppe Chiaramonte, I-90145 Palermo, Italia; Zef Chiaramonte <zef.chiaramonte@yahoo.it> To Simë Dobreci <fdobreci@t-com.me>, Date 08.06.2017 22:1. Komentoi S.Gj.D.

ZËRI KËNDIMTAR I SHESTANIT

Shkruan **Dr Rrustem Berisha**, Prishtinë

Pagëzimi i veprës KRIJIME POPULLORE SHESTANASE të prof. Dr Simë Gjon Dobrecit, tregon se dimensioni i saj kryesor është artistik. Këtu ka material të prodhimit letrar të popullit të llojeve të ndryshme dhe, natyrisht se është me vlerë solide.

Kryesisht, në vepër janë publikuar këngë të popullit që në pikën e sasisë zotëron lirika. Lirika jo vetëm si sasi, por edhe si cilësi arti, është më tepër e përkryer. Disa nga këngët lirike këtu, të themi se është bërë zakon të konstatohet, kanë vlera të gjenden në faqet e antologjive të llojeve përkatëse.

Disa variante të këtyre këngëve i hasim në publikimet folklorike, kjo është e ditur, sepse Shestani ka pasur lidhje tradicionale me tërë hapësirën midis Ulqinit dhe Shkodrës dhe me malet përreth tij.

Duhet thënë drejt se libri sjell edhe një sasi të materialit gjuhësor, disa të dhëna historike të mbështetura në arritjet e shkencave dhe portrete njerëzish shestanas, të cilët si krijues e veprimtarë meritueshëm kanë zënë vend në kujtesën e vendasve, madje edhe në hierarkinë e krijuesve të çmueshëm. Ata janë bërë pjesë me vlerë të historisë së Shestanit, prandaj prof. Dr Simë Gjon Dobreci, duke i radhitur këtu e ka forcuar kujtesën tonë edhe nderimin për ta.

Qëndrimi personal, karakteri i tyre i fortë, dashuria për Shestanin dhe shqiptarët, që ata thanë me shkrimet e tyre në kohët e duhura e të vështira i shpie ato figura në radhën e personaliteteve të kombit tonë.

Si po them, libri ka një material edhe pak më të ndryshëm se ç'është pagëzuar, por me te i shtohet vlefta edhe më tepër. Pretendimet e prof. Dr Simë Gjon Dobrecit nuk janë edhe aq modeste kur në to e shohim njeriun vullnetfortë, të pathyeshëm në qëllimet e tij për t'i shtruar e shkruar drejt të vërtetat. Kjo e bën, po them kështu, autorin dhe veprën e tij me sukses.

Një shikim të thjeshtësuar do e bëjmë sipas kapitujve të librit që është vetëm pamje e një pjese të vlerave, të cilat hapen e mbyllen brenda 257 faqeve.

Në fillim të kësaj përmbledhje këngësh është publikuar poezia e Gjergj Fishtës "Gjuha shqype" që është tingëllim kushtrimi për ta ruajtur dhe folur gjuhën amtare. Këtë ide e këtë qëllim e thekson shumë shpesh prof. Dr Simë Gjon Dobreci, të thuash në çdo shënim të shkurtër apo në çdo shkrim më serioz.

Këngët që autori i librit i sjell këtu do të ligjërojnë edhe vite e vite, ato nuk duan t'ia dinë se a po mbetet Shestani pa banorët e vet, pa ata që i krijuan apo i kënduan. Ato do ta përcjellin jehonën e dashurisë, të dasmës, të vajtimeve, të trimërive përgjithmonë të fiksuara në libër dhe të ruajtura në kapitalin e folklorit tonë. Ato si kanë tingëlluar me vite e shekuj ngrohtë, do ta mbajnë të ngrohtë edhe më tutje këtë krahinë dhe tërë prehrin e kraharorin e Krajës.

Dobreci këta prodhime letrare i solli në libër pas disa viteve me radhë që i publikoi në revistën "Buzuku".

Në këngët e dashurisë poetizohet nga rapsodët mosha më e lumtur e jetës. Ajo nuk është jetë pa pengesa e pa brenga, por të gjitha kalohen gëzueshëm, sepse është vetë moshë e fitoreve që i gjen rrugët e dëshiruara dhe të mundshme.



Në dashuri edhe sakrifica është fitore. Në këngë reflektohet sinqeriteti i plotë midis të rinjve. Dy epitetet që i jepen vajzës *mollë e kuqe top sheqere* përcillen me mangësinë se ka mbetur e vogël. Vogëlsia ka arsyen se ajo një përkrahje nuk e gjen të prindit pleq, por e shpreson te e motra.

Kënga e bën të padukshme vogëlsinë, sepse vajzës i janë bërë përshkrime që zgjojnë ndjeshmërinë me krahasimin më gjerat e bukura dhe me shije të mirë.

Në lirikën e dashurisë trajtohet motivi i rrëmbimit të femrës. Një temë e tillë trajtohet në këngën *Larg ma lulldonjin nji vashë*, në të cilën ka përshkrime mjetesh, veshjesh, veprimesh, mallrash të tregtisë.

Përsosmërinë e rrëfimit e shpreh ligjërimi i rregullt në këngë që krijon një taktizim kur të dukën tri femra e djali duhet ta dallojë atë që kërkon. Pra, është këngë me stil të veçantë që vazhdon kah qartësimi dhe lehtësimi i veprimit për të rrëmbyer vajzën.

Dashuria shprehet në trajta të ndryshme dhe me ngjyrime të plota të shijeve. Në këngën 'Dal n'abarr me mjelun dhentë', pas bisedës së shkurtër të vajzës me djalin bëhet një kontakt me shijet që ndjehen me femra të trevave të ndryshme, bëhet bisedë për monotoninë që tregohet në muhabetin e tillë sidomos në moshat e shtyra. Duket sarkastike të krijohet atmosferë dashurie midis pleqve e plakave.

Kemi në përfytyrim përjetimin e *Mrika Lenës* që i ka frikën e ruhet prej një djali për arsye të hasmërisë, siç jepet një shënim, por ajo prapë bashkohet me te, ndërsa e ëma gëzohet e uron, që pikërisht e merr vajzën ai që e don.

Është kjo një këngë me shumë vargje, me rrëfim të logjikshëm dhe po mungoj diçka në njërën variant si pyetje apo përgjigje, doemos e gjen me mend se si është rrjedha e drejtë dhe vërtetë. Këto përsëritje të pyetjeve dhe përgjigjeve kanë ngjashmëri me refrenin dhe i japin bukuri e kuptim këngës.

Në këngën 'Nën nji mollë e nën nji dardhë' jepet përfytyrimi qesharak i takimit të vajzës dhe të plakut, madje takimi i fatshëm i vajzës me djalin e ri. Pamje këto që i ka pasur edhe realiteti jetësor.

Dasma, festa më e gëzueshme e familjes shqiptare, është paraqitur këtu me valle, këngë, ngritje dollish. Si gjithmonë, vajza nguron të ndahet nga familja, tek djali e ftojnë me gëzim se edhe atje do të bashkohet me njerëz që do ta duan e afrojnë si njerëzit e gjakut.

"Po këndon zogeja m'llinjë" është një porosi që u drejtohet të rinjve që të marrin vajzat e mira, sojnike, sepse pasojat janë më të këndshme. Nusekeqi ka mort gjithmonë në shtëpi, e kjo do të thotë ka jetë të hidhur. Nusemiri ka gjithmonë dasmë e gëzim, prandaj mos të ftohet fare në dasmë. Është kjo një porosi e traditës që me martesë të mbarë të krijohet lumturia familjare.

Përfytyrimin për barinjtë dhe rolin e tyre e jep kënga e njohur "Blegeron delja në mal". Ajo jep me siguri vlerën e kujdesin e bariut që dëshmon se ky e forconte një veprimtari me të cilën populli ka siguruar ekzistencën.

Kurbeti është një tragjedi, siç dihet historikisht, që e përcjell popullin tonë kaherë, me shekuj. Mërgimi ka tharë, si thuhet, shumë zemra prindërish, grash, fëmijësh, ka fikur shtëpi. Si dhimbje e rëndë, mërgimi ka frymëzuar një lloj këngë të veçantë, e cila shpreh brengë, mallëngjim dhe pikëllim. Të gjitha këto ndjenja përjetohen mundimshëm.

Vepra "Krijime popullore shestanase" e nis këtë cikël këngësh me "More Kraja nën Rumi". Pikëllimi këtu bie mbi krahun e gjerë të një krahine me të shprehurit e frikës se ata do të çkombëtarizohen, do të tresin me gjuhë e besim në valën e kombit tjetër.



mëvetësishme.
Me rëndësi është se në to, megjithatë, dukët e sotmja. Është fakt se disa krijues kanë shkruar aq popullorçe sa poezitë e tyre janë kënduar nga rapsodët e popullit.
Të kujtojmë poezitë e Hil Mosit, të Gjergj Fishtës, të Naimit, Çajupit, që janë bërë këngë popullore. Kjo shkrirje talentesh, të themi popullorçe, kah do që t'i sjellësh e ta marrish, na qet te buka jonë. Unë e çmoj një ndihmesë të tillë.
Tani po i zëmë me pak fjalë këtu këngët historike. "Kanga e Caf Metos", një trim që vret tre e plagos dy vetë, flet për amanetin që i lë nënës t'ia sjellë djalin në Shkodër, t'i tregojë ku e si ka luftuar i ati me bindje se trimërinë po e le trashëgim, dhe është porosi që vjen nga breznitë.
Këngët historike këtu japin shembuj krenarie në luftërat me armiqtë e vendit. Të tillë trima janë Luc Pjetri, Çun Mula. Këndohet për Luftën e Parë Botërore dhe të Dytën, kur fqinjët turren të tërbuar mbi shqiptarët me qëllimet e tyre hegjemoniste, okupuese dhe kriminale. Por, si thuhet në këngë, nuk e marrin atë që presin, sepse:
Met serbjani e cërnagori,
Dhetë për nji u pague Malsori.
Lufta e Taraboshit e tregon qëndresën e shqiptarëve kundër serbëve e malazezve. Por, ngulet vullneti për t'u mbrojtur Shkodra.
Tematikë mbrojtëse na thotë edhe kënga "Nji t'mërkure n'iqini", ku mbrohet Ulqini. Këtu janë emrat e luftëtarëve të njohur të kohës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, si Veli Mani, Halil Qatja e Hyso Shestani.
Në ciklin "Legjenda balada elegji" prinë "Ag' Ymeri na u martuo". Kjo është këngë e vjetër që lidhet me trevën e Ulqinit dhe është si art një lloj xhevahiri. Moti i kthimit të burrit është motiv antik i trajtuar nga Homeri. Pos një numër faktesh, motivit tonë ia shton origjinalitetin dashuria e respekti i kryepersonazhit, Aga Ymerit, për babën, nënën, shtëpinë e madje për grua. Shenjat e njohjes dhe koha e gjatë e mostakimit janë elemente të letërsisë popullore si kode të vjetra për t'u riafruar të dashurit.
Ndër këngët legjendare që shquajnë në trupin e tyre rrëfime bindëse e bukuri arti janë "Kanka e Kalasë së Shkodrës", "Kënon blega", "Nantë vllazni kishin nji motër" "O i mjeri, more nanë", "Oj Rumia bjeshkë e naltë" etj.
Në balada e legjenda shquhen konfliktet dhe vetëflijimet që paraqesin inertes të zbërthehet arsyeja e tragjikës dhe shkaktarët. Këta faktorë thelbësorë të këtyre krijimeve janë përbërës esencialë dhe shkaktojnë plot dhembje e pikëllime me jehonë të fortë.
Këngë kreshnike është vetëm një dhe ajo ka, mendoj, rëndësi shumë për t'u qartësua disa gjykime që janë dhënë për eposin tonë. Kjo këngë "Në Fushë t'Udbinës" me personazhe krishtere, katolike mund të na jep një fakt për fillime më të hershme të eposit tonë, sepse është supozuar e pohuar që në këto këngë ka ushtruar ndikim pushtuesi turk.
Në fushën e gjuhës Dobreci sjell fjalë të urta, thënie të ndryshme nga aktivitetet e njerëzve dhe sjelljeve të mira e të liga, të cilat janë ligjërime të dendura me domethënie kuptimore të thella. Nga respekti e dashuria ai i ka pagëzuar "fjalë flori të shestanase", "Disa përshëndetje e urime të shestanase", "Disa mallkime, troma shestanase". Madje vijnë emrat e familjeve, të meshkujve dhe të femrave, ku herë herë autori kërkon rrënjën dhe domethënien e tyre në shqipe.
Përvoja e provuar jetësore e konkluduar në shprehjet e tilla është konsideruar si mendim i lart filozofik, si udhërrëfyes në jetë. Shumicën nga këto thënie edhe sot populli i përdorë përfillshëm.
Shkrimet që janë bërë për individët, duke filluar nga figura e Buzukut e deri te Pjetër Perkoliqi, japin shkurtas portretet e njerëzve që me veprën e tyre u bënë shenjë krenarie e shestanasve, madje edhe emblema në kulturën kombëtare. Ata pos formimit të tyre intelektualë të lartë dispononin atdhedashuri dhe guxim dhe jetuan e vdiqën, duke mbetur individë të ndritshëm.
Këta emra nuk janë shumë, por janë për t'u kujtuar gjatë, Lekë Perkolonj, Dom Pjetër Perkoliqi, Patër Vinçens Malaj, Patër Zef Jankaj, Patër Zef Tagaj.
Nëpër faqet e librit ka një numër të konsiderueshëm fotografish, ku secila me përmbajtjen dhe emrin e vet paraqet dokument për besimin, për bujqësinë, festat familjare e popullore, për blegtorinë, veshjet kombëtare, lojërat e vallet, shtëpitë, kishat.
Ato janë dokument i jetës së gjallë të Shestanit, pjesë e lumturisë që e përjetuan dikur shestanasit, por janë edhe pjesë dëshpëruese sot me pamjen që dëftojnë rrënojat e shtëpive lënë të shkreta.
Kjo vepër e Prof. Dr Simë Gjon Dobrecit është nisur në udhëtim. Ajo do të arrij tek individët, tek nxënësit, tek studentët, tek studiuesit dhe do të vendoset nëpër biblioteka që janë tempulli i librit. Vepra dhe emri i autorit do te flasin ëmbël e burrërisht përmes këtyre këngëve. Ky art do të na i kujtojë blerimin, shkëmbinjtë, përrenjtë e thepat, Ruminë e lartë, zilet e bagëtive, rreshtin e dasmorëve gjithmonë deri sa të shkruhet e të flitet shqipja. Kam frikë, ashtu si na njofton libri, për katastrofën e zbrazjes së Shestanit, se mos vepra është zëri i fundit i artit që dëgjohet e shënohet prej andej.
Nuk shpërblehet autori me fjalë. Prof. Dobreci dhe arti shestanas do të jenë vet ngrehina që na pasuron me kujtime për një skaj shqiptar mundimtar dhe krenar, ku Sima dhe libri i tij do të qëndrojnë ashtu me ballin e shkëmbit të patundur. Dine se libri brenda ka më shumë bukuri e rëndësi, sesa i përmenda ketë herë.
Kumtesë mbajtur në Ulqin, më 28.07.2017 në përurimin e librit.



PJESË NGA DETARIA E ULQINIT

Shkruan: Gazmend Çitaku

Të flasësh për detarinë e Ulqinit padyshim se nuk mjaftojnë faqet e një reviste apo edhe e një libri. Por, detaria e Ulqinit duhet punuar me seriozitetin më të lartë dhe ajo të pasqyrohet që nga fillet e qytetërimit në këto anë apo sipas gjetjeve arkeologjike që nga neoliti i vonshëm. Duke qenë një vend bregdetar patjetër që ekonomia kryesore e vendasve të ketë qenë peshkimi e së bashku me te edhe lundrimi apo më mirë të themi detaria. Muri ciklopik në pjesën veriore të kalasë së Ulqinit daton nga shekulli VI-V p.e.re dhe ende sot paraqet kontinuitetin e jetesës së pashkëputur të kësaj hapsire deri në ditët e sotme. Nëpër periudha të ndryshme Ulqini ndërroi disa herë emrin e vet e gjithashtu edhe pushtuesit. Sot qyteti i Ulqinit njihet si një perlë e Detit Adriatik ku janë të gërshëtuara arkitektura dhe etnografia parailire-ilire-romake-bizantine-venedikase-osmane së bashku me atë moderne të ditëve të sotme.

Mjetet lundruese ishin të llojeve të ndryshme dhe ato mvareshin nga forma dhe madhësia kurse ne po i numërojmë vetëm ato që kishin vela: Liburna, Lemba, Bark, Barka, Barkusi, Braceri, Briku, Brigantina, Cakora, Karaka, Karavella, Kekija, Kokina, Felluka, Fergaduni, Fregato, Fustë, Gajetë, Galija, Gripi, Lanca,Leut, Marsiliana, Martigani, Nava, Peota, Peligu, Pinka, Pulaka, Sagena, Sajeta, Shambeku, Shkaba, Shkuna, Tartana, Trabakulli, Vashelli, Zolisi, Zopulimi.

Detarët ulqinakë, si mbrojtës të tyrin në pafundësinë detare, në kohën e ilirëve kishin Redonin e pastaj në periudhën e sundimit osman mbrojtje kërkonin nga Hazreti Nuhi të cilit detarët edhe festonin një ditë në vit e ajo ishte *Dita a Hashures* në të cilën ditë përgatitej në kazana të mëdhenj hashurja dhe i shpërndahej gjithë popullsisë lokale.

Ulqini si qytet bregdetar jetesën e ka siguruar nga deti. Përmes detit u kalitën në detarë të shkathtë ”ujq deti” ku në periudha të ndryshme kohore më të shquarit ishin: **Haxhi Aliu** - Në Sazan njihet Shpella e Haxhi Aliut ku detarët shqiptarë sa herë kalonin atypari në detë hudhnin pak bukë dhe vaj ulliri, **Ali Kaceni** i njohur në popull si **Lika Ceni** ishte një detarë i pashoq i shkathtë dhe dinak madje falë zgjuarsisë së tij ikën nga kthetrat e Sulltanit. Vendbanim të vetin Ulqinin e kishte edhe **Uluç Alia** të cilin pas Betejës së Lepantit, Sulltani e emron Bejlerbeg të Algjerit e shumë të tjerë. Në periudhen e para një shekulli dmth në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX detarët ulqinakë që ishin pronarë anijesh më të mëdha të kohës njihen familjet**: Shurdha, Bilali, Gjyli, Tivari, Nimanbegu, Beci, Shabani, Idrizaga, Kapidani** etj.

Anijet ulqinake të po kësaj periudhe që kishin mundësi të transportonin më shumë se 500t ishin: **Gloria** 800t – **Selim Shurdha**, **Hulusie** 1000t – **Ismail Shurdha**, **Mumuni** 1800t – **Jakup Niman Begu**, **Poskiq** 1500t – **Vëllezrit Niman Begu**, **Marte** 571t – **Fazli Begu**, **Zeitunie** 500t – **Ibrahim Cakuli** etj. Ndërsa lista e anijeve me mundësi ngarkese nën 500t është e pafund dhe për më tepër këshillohen lexuesit që të konsultojnë librin *Flota shekullore detaro-tregtare e Ulqinit* të autorit ulqinak dr Maksut Haxhibrahimit ku çdo gjë është e pasqyruar shkëlqyeshëm. Në po të njejtin libër paraqiten si pronarë apo kapidanë anijesh edhe personat në vazhdim mirëpo emri i anijeve nuk është i njohur por vetëm tonazha: **Abdyl Latif Beci** 850t, **Jahja i Tul Velisë** 500t, **Jonuz Beqir H. Ali** 1600t, **Shaqir Pelinku** 800t, **Xheladin Ismail Aga** 900t, **Ahmet Sylejmani** 700t, **Mahmut Tivari** 650t, **Adem Kamina** 650t, **Shaban Begu** 600t, **Daut Asllan Pelingu** 500t, **Dalip Luli** 1000t, **Hasan Luli** 2000t, **Zenel Gjyli** 1000t.


Anija “Mashalah Bilali” (Ex “Conte Geza Spazy”) pronë e Selim Bilalit

Pra, këtu pasqyruam në vija të vrazhda vetëm një thërrime të detarisë ulqinake e cila padyshim se është shumë shumë e pasur edhe me leksik detar, traditë lundrimi, anijendërtimtari etj. Ulqini si vendbanim paraqitet që në harta më të moçme antike e deri në ditët e sotme. Andaj mund të konkludojmë se për Ulqinin është shkruar shumë pak e Ulqini meriton shumë më shumë, meriton një Muze Detar, meriton që të bëhen shumë hulumtime si arkeologjike ashtu edhe arkivore sepse Ulqini ka çka të ofrojë e të pasqyrojë. Ato vetëm duhet shpalosur.

TREGIME TË ÇUDITSHME NGA ULQINI

Shkruan **Prof.dr. Rrustem Berisha,** Prishtinë



Letërsia trajton tema të varfërish dhe të pasurish, trimash e frikacakësh, besnikësh dhe tradhtarësh, luftërash dhe paqeje, miqësh e armiqësh, gëzimesh dhe dëshpërimesh, vendesh krimi dhe vendeve të argëtimit. Ajo e kumton jetën përmes rrëfimeve dhe përjetimeve.

Pra, është jeta të cilën e ndjejmë shpirtërisht nga fjalët e ka shumë nga këto i njohim në veprën e Gazmend Çitakut ”Tregime të çuditshme nga Ulqini”.

Këto tregime më parë janë të thëna nga mendja e popullit në trajtë kallximesh, legjendash. Gazmendi, themi kështu, i ka riletrarizuar. Tema të tilla nga letërsia e tabanit tonë kombëtar kanë trajtuar me sukses Mitrush Kuteli (Tregime të moçme shqiptare – nga këngët kreshnike), Gjergj Fishta (i cili e ka mbështetje rapsodinë e kreshnikëve), Ismail Kadarea, i cili kaptin në trajtë moderne në disa nga legjendat tona më të mira), pastaj Adem Demaçi, Rexhai Surroi, Rexhep Qosja etj.

Gazmendi, si fillestar në shkrimin e prozës, ka ritrajtuar dhe riletrarizuar legjenda të këtij qyteti, por ka treguar prirje të mirë narracioni, duke u dhënë gojëdhënave e legjendave një shtrirje e dimension që e tipizojnë me shenja të veçanta jo vetëm lashtësinë po edhe të sotmen.



Këto tregime e sjellin te lexuesi zërin e gjeneratave të hershme, sjellin vlerën e njerëzve të formuar me karakter të mirë, na i shfaqin pamje të hershme të Ulqinit dhe të rrethinës së tij me komunikimin bashkëkohës që u jep autori. Në këtë mënyrë, sikurse i lexojmë, tregimet çmohen me vlerë më të madhe. Ku gjenden ata rrëfimtarë – dijetarë popullorë që i krijon e i rrëfen? Nuk janë më në jetë, prandaj autori i ka bërë të flasin në mënyrë të re. Ai nuk ka shprehur pretendime se këtu janë thënë e shkruar të gjitha. Populli i vendit ka shumë më tepër begati letrare. Sigurisht krijuesit e këtushëm do t'i trajtojnë kush në poezi, kush në drama, kush në romane dhe Ulqini do shkëlqejnë ashtu si i ka hije një qyteti me moshë të vjetër.

Mendoj, ashtu si ndihem vetë, lexuesi do të entuziazmohet me leximin e veprës së Gazmend Çitakut. Lexuesit e vendit do të krenohen me Likacenin, me Lutin, me Hysejnin etj., nëpërmes të të cilëve fiksohet tradita e banorëve të këtushëm me veçoritë më njerëzore, atdhedashëse.

Ata që sot këtu janë të pranishëm e të ri, shpresoj se ata do kenë rastin ta përgëzojnë Çitakun për vepra të tjera dhe më të suksesshme.

Unë e uroj tash



(Fjalë e mbajtur me rastin e përurimit të librit TREGIME TË ÇUDITSHME NGA ULQINI të autorit Gazmend Çitaku më 01.07.2017 Ulqin)

KATEDRALJA DHE MARTIRIZIMI I SHQIPTARËVE

Shkruan **GJOKË DABAJ**



Më 3 shtator 2017 u përurua në Tivar Poshtë Katedralja e re e Arqipeshkvisë së Tivarit. Nuk mund të them me shifër sa njerëz qenë mbledhur, por salla, që s'është e vogël, qe mbushur plot dhe më këmbë anash mund të ishin më shumë se njëmijë vetë. Jashtë gjithashtu qëndronte një turmë mjaft e madhe.

Ish kjo pamje, e mjaftueshme për të kuptuar sa e rëndësishme ish ajo ditë për katolikët, shtetas të Republikës së Malit të Zi, që gravitojnë rreth asaj Arqipeshkvie. Kishin ardhur shestanasit që banojnë në Tivar e rrethina, shestanas që banojnë në fshatrat afër Ulqinit, klleznorë e bregasorë, malësorë të Tuzit, Hotit, Grudës e Trieshit. Kishin ardhur që nga SHBA-ja dhe shtete të Evropës Perëndimore me qindra mërgimtarë.

Në rrethinë të Tivarit, psh në fshatin Zupç apo në Sutomore, ka një numër katolikësh që tradicionalisht flasin gjuhën sllave. Gjithë kështu edhe në Grykat e Kotorrit shumica e banorëvet janë katolikë sllavishtfolës. Krejt natyrshëm ishin edhe ata të pranishëm midis shumicës shqiptare, pjesëtare shumëshekullore e kësaj Arqipeshkvie.

Arqipeshkvia e Tivarit është një institucion fetar katolik njëmijë vjeçar, më saktë, 928-vjeçar, i Arbërisë Veriperëndimore e në vazhdim i Shqipërisë Veriperëndimore. Themeluar si Arqipeshkvi që në vitin 1089 dhe martirizuar në të gjithë shekujt e ekzistencës së saj.

Unë kam shkruar e botuar, në shqip dhe sllavisht, një libër nja 300-faqeh për historinë e kësaj Arqipeshkvie, prandaj dhe nuk ka arsye të zgjatem më shumë, as në renditjen e faktevet të historisë, as në arsyetimet, pse kjo Arqipeshkvi shoqërohet me epitetin ***e martirizuar***.

Por është e domosdoshme të ndalemi te pyetja: ***Pse po vazhdon edhe sot të martirizohet kjo Arqipeshkvi?!***

Kur themi ***po martirizohet*** një institucion, qoftë fetar, qoftë i fushavet të tjera të kulturës, fjala është për popullin që grumbullohet rreth atij institucioni.

Pra: ***Pse po vbazhdon të martirizohet populli, dikur arbëror e tash shqiptar, i grumbulluar rreth kësaj Arqipeshkvie këtu e një mijë vjet?!***

Unë isha i ftuar në atë ceremoni me firmën e vetë arqipeshkvit Imzot Rrok Gjonlleshaj. E pata ndjerë veten të nderuar që më ish dërguar ftesa dhe udhëtova prej Durrësit një ditë para se të zhvillohej ceremonia. Ishte thënë në rrjetet socialë që mesha do të celebrohej shqip, ose të paktën e kombinuar, shqip edhe sllavisht, dhe kjo më gëzonte shumë, mbasi në kishat e Tivarit dhe në ato të rrethinës së Tivarit, ku shumica dërrmuese e besimtarëvet janë shqiptarë, ka rreth 120 vjet që mesha nuk celebrohet në gjuhën shqipe, por në gjuhën sllave. Shkak për këtë është bërë një konkordat famëkeq, një marrëveshje famëkeqe, midis Vatikanit dhe qeverisë së atëhershme princore të Malit të Zi, në fund të shekullit XIX.


Mali i Zi i sotmi, jo vetëm duhet, por e ka detyrë të zbatojë në të gjitha fushat e jetës parimin e demokracisë bashkëkohore evropiane. Ky është kusht që ky shtet të mund të pranohet si anëtar me të drejta të plota në Bashkimin Evropian.

Sado që i njoh mirë marifetet që përdorin politikanët serbë, e, nën diktatin psikologjik kishtar pravosllav të sërbëvet, edhe një pjesë e politikanëvet malazezë, prapëseprapë po shpresoja që, në politikën aktuale të Malit të Zi diçka të ketë ndryshuar. Po shpresoja që faktori shqiptar të jetë vënë në vendin që i takon në Arqipeshkvinë e Tivarit, si zot shtëpie në atë Arqipeshkvi dhe si faktor jetëdhënës i atij institucioni.

Unë jam nga Shestani. Gjuhën shqipe e kam mësuar në Shestan. E kam marrë si qumështin e nënës, në rritje e sipër. Gjyshja ime nuk ka ditur asnjë fjalë sllavisht, sado që kishim shtatëdhjetë vjet nën pushtimi malazias e jugosllav. Gjyshi im dinte vetëm dy shprehje sllavisht: ***Dobar dan*** dhe ***dobro veçe***. (***Mirëdita*** dhe ***mirëmbrëma***), shprehje këto që i kish mësuar thjeshtë për mirësjellje, sepse nuk mund t'i kalosh tjetrit, qoftë edhe jabanxhi, pa e përshëndetur.

Uratat, ***Ati ynë, Falemi Mri, Kjothtë lumnia e Atit, Besojmë, Unë pej Zotit jam i kshtenë, Puna e penimit***, m'i kanë mësuar prindët dhe famullitari ynë në Shestan.

Tani ka ardhur koha që qeveria dhe politikë bërësit e shtetit malazias ta kuptojnë se ndaj shqiptarëvet të Shestanit dhe ndaj shqiptarëvet të tjerë, shtetas të atij shteti, është bërë diskriminim në regjimet e mëparshëm dhe se, më në fund, ajo praktikë diskri-



minimi duhet të ndërpritet.
Një grumbull i madh klerikësh: Arqipeshkëv, ipeshkëv, meshtarë e rregulltarë, madje edhe kardinali, Hirësia e Tij Ernest Troshani, ishin të pranishëm dhe po e udhëhiqnin ceremoninë përuruese të katedrales së re. Ish kënaqësi e veçantë kur, midis asaj ceremonie, dëgjoje gjuhën shqipe, gjuhën e vendit, dhe reagimin, fetarisht të përkushtuar, të pjesëmarrësvet. ***Lutu për ne***, thoshte një nga drejtuesit e ceremonisë dhe përgjigjja shqip, ***lutu për ne***, bënte që krejt katedralja të gjëmonte me të madhe. Kjo dëshmonte që besimtarët e pranishëm në atë ceremoni ishin thuajse që të gjithë shqiptarë.
Mirëpo liturgjia shërbehej kryesisht në gjuhën sllave dhe kori i kishës i këndonte lutjet në gjuhën sllave.
Duke e ditur që shumica e klerikëvet ishin shqiptarë, unë isha i prirë të merrja me mend edhe ndrydhjen shpirtërore që e përjetonin ata klerikë. Nuk ish e mundur që ata të dëshironin për ta thënë meshën sllavisht, në një kishë shqiptare, të mbushur plot me besimtarë shqiptarë. Isha i prirë të përfytyroja edhe debatet që ata mund të kenë bërë në rrethet e tyre të mbyllur dhe presionet që, në mënyra e forma të ndryshme, janë ushtruar mbi ata klerikë dhe përfundimisht ata kanë qenë të detyruar të veprojnë ashtu si nuk dëshironin dhe si, Zoti, të cilit ata i besojnë, nuk do ta miratonte kurrë.
Televizioni shtetëror malazias do të ish aty i pranishëm. Klerikë të besimevet të tjerë do të merrnin pjesë si të ftuar. Duhej doemos të krijohej përshtypja sikur shteti i Malit ë Zi është një shtet demokratik nga më të kulluarit, të cilit duhej t'i hapeshin dykanatesh dyert e BE-së. Duhej të krijohej edhe përshtypja e shkuarjes mirë midis konfesionevet të ndryshëm, pravosllavë, myslimanë e katolikë, por, në krahun tjetër, nuk duhej lënë përshtypja që kjo Arqipeshkvi ka qenë dhe do të mbetet ekskluzivisht një institucion i besimtarëvet katolikë shqiptarë. Kjo ish shumë e rëndësishme për shovinistët malazias të kamufluar si demokratë.
Shprehja më flagrante e falsitetit të asaj ceremonie, mbuluar me petkun e "demokracisë", ishte demonstrimi i dy veshjeve kombëtare.
Njëra veshje paraqiste kostumin malazias, në një kohë që gjithkush e di që nuk ka në botë as edhe një malazias të besimit katolik. Të gjithë malazezët janë ose pravosllavë, ose ateistë. Katolikë janë një numër shtetasish malazias, shqiptarë dhe kroatë, por katolikë me kombësi malaziase nuk ka gjëkundi. Megjithkëtë, ata u paraqitën aty si pjesëmarrës në ceremoni dhe i dorëzuan arqipeshkvit, para kameravet shumë të vëmendshme televizive, një dhuratë simbolike.
Një çift tjetër me veshje popullore ishte nga fshati Zupç. Ai fshat ka vërtet një veshje karakteristike , interesante, ashtu siç ka edhe një etnohistori disi enigmtike, por gjithsesi ishte përfaqësi e një fshati të vetëm.
Veshja e Shestanit, veçanërisht e gravet të Shestanit, e cila është ruajtur këtu si një dëshmi tepër e lashë iliro-arbro-shqiptare, nuk u paraqit asgjëkundi. Komisioni përgatitës i asaj ceremonie kish bërë kujdes që të mos dukej askund andejpari ndonjë grua apo nuse me veshje shestaneshe. Vetëm dy plaka më zuri syri midis turmës me atë veshje, por nuk e di në i ka kapur apo s'i ka kapur qoftë edhe gabimisht kamera televizive.
Edhe katolikët shqiptarë të Klleznës, edhe ata të Malit të Brinjës, Shëngjergjit e Shënkollit dhe të krejt bregut të djathtë të Bunës, i kanë veshjet e tyre karakteristike, por asnjëra prej tyre s'ish parë e arsyeshme të paraqitej në atë ceremoni solemne. Veshjet e Malësisë së Madhe, Hotit, Grudës, Trieshit dhe Tuzit, ashtu si dhe veshjet e Shestanit dhe të Bregbunës, duhet të përbëjnë objekt krenarie jo vetëm për ne shqiptarët, por edhe për shtetin e Malit të Zi. S'ishin, pra të pranishme në atë përurim aq të rëndësishëm asnjëra nga ato veshje, sado që aty kish me shumicë edhe malësorë, të ardhur madje që nga SHBA-ja enkas për këtë ngjarje.
Askush nuk mund të thotë që kjo mungesë e veshjevet kombëtare shqiptare, në inaugurimin e një katedraleje thuajse tërësisht shqiptare, të ketë qenë e rastësishme apo pasojë e neglixhencës. Përkundrazi, është shprehje e diskriminimit të pandalshëm ndaj popullsisë autoktone shqiptare, filluar që prej vitit 1877 e këndej.
Duke përjetuar gjithë këtë ngjarje, me përzierje të dukshme të një farse mediatike, po më vinin pa pushim në mendje dy vargje të një poeti të madh malazias Petar Drugi Petroviq Njegoshit: "***Çashu meda josh niko ne popi, shto je çashom zhuçi ne zatopi!***" ("***Got'n e mjaltit askush dot s'e piu, të papërzier me gotë helmi të hidhët!***")
Ne katolikët shqiptarë të atyre hapësirave, të ndodhur nën Malin e Zi e nën Jugosllavi qysh prej vitit 1877 e këndej, më shumë se pesë breza, pa shërbim kishtar shqip dhe pa shkolla shqipe, sidomos Tivari e Shestani, më shumë e kemi shijuar helmin se mjaltin. Dhe, me sa duket, shpërbërja jonë kombëtare e kulturore do të vazhdojë shumë e egër edhe në këto kohë aspiratash të reja. Helmi nuk do të na mungojë.



E botoi KOHA JAVORE 782, 21 shtator 2017:12-13.

Nji kjothtë qi doni mos me ju nemë (mallkue) nipat e mesat, mos e hupni gjuhën e vet n'shpi t'vet (SGjD).

POLITIKA SI ARTI I QEVERISJËS

Gjon Keka, Antropologjia politike, Botoi: Botart, Tiranë, 2015

Shkruan **Dr. Nail Draga**

Viteve të fundit nga autor të ndryshëm shqiptar janë botuar studime dhe botime të veçanta nga fusha të ndryshme si nga aspekti shkencor, kulturor, artistik, publicistik etj., duke pasuruar fondin e botimeve të tilla në lëmit përkatëse. Nga kjo gamë e gjerë autorësh bën pjesë edhe Gjon Keka i cili dallohet në hapësirën etnogjeografike shqiptare, për cilësinë dhe sasinë e botimeve. Një nder botimet e tij të fundit është edhe libri *"Antropologjia politike*", botuar në nga "*Botart*" në Tiranë në vitin 2015. Nga vet titulli i këtij libri por edhe lënda e trajtuar del qartë se kemi të bëjmë me një përpjekje të guximshme të autorit, i cili trajton një qasje të re te mendimit politik tek ne shqiptarët. Një konstatim të tillë e themi me faktin se në këtë periudhë posmoniste e cila njihet si koha e tranzicionit, botimet e kësaj natyre kanë qenë të pakta, nga fakti se tek ne ende është i pranishëm mentaliteti i së shkuarës totalitare, për qasjet shoqërore dhe rrjedhat bashkëkohore të shoqërisë pluraliste.



Pikërisht duke marrë parasysh të kaluarën tonë në kuadër të ish kampit të vendeve socialiste, termi *"antropologji politike"* është një term pothuaj i panjohur. Antropologjia apo shkenca mbi njeriun përbën po ashtu edhe fushën e lidhjes se njeriut me shtetin, drejtimin e shtetit nga njeriu dhe pushtetin shtetëror, shoqërinë, shkallët e zhvillimit, kulturën etj.

Ndërsa antropologjia politike e trajton njeriun si personalitet , si individ dhe si qenie kulturore, përkatësisht ka të bëjë me strukturën e sistemeve politike, proceset politike, zhvillimin e shoqërisë, institucioneve, shtetit dhe të kulturës së popujve, duke iu qasur në mënyrë strukturale lidhjeve formale dhe joformale të politikës, proceseve kulturore, sociale, ekonomike etj.

Në kuptimin më të gjerë antropologjia politike është sinonim me politikën, ndërsa ne kuptimin më të ngushtë, ka të bëjë me aftësitë politike të artit të qeverisjes, shtetit dhe politikës, të cilat mund të thuhet se janë edhe sferat mbi njohuritë politike në përgjithësi. Me një fjalë antropologjia politike është pjesë e filozofisë politike e cila hulumton mënyrën e organizimit politik të shoqërisë në një mjedis të caktuar.

Autori në këtë botim më në detaje trajton frymën inspiruese të ideve dhe të teorive të politikës, formimit të shteteve, legjislacioneve, sistemeve dhe institucioneve politike, kulturës politike, gjuhës politike etj.

Pra kemi të bëjmë me një përpjekje të autorit në fushën e shkencës politike, i cili është nder të parët që kësaj çështje i qaset në mënyrë profesionale. Pikërisht këtu qëndron edhe vlera e këtij libri, se shumë çështje të pa trajtuara deri më tash nga autorë shqiptarë, me këtë libër vërehet përpjekja e parë profesionale, ne këtë drejtim.

Andaj duke lexuar këtë libër del qartë se shoqëritë tona me të kaluar moniste edhe tash ne pluralizëm kanë sfida të mëdha për të konsoliduar demokracinë liberale, kulturën politike, të drejtën dhe lirive qytetare dhe nacionale sipas standardëve bashkëkohore të shteteve me përvojë demokratike. Ndërsa neglizhenca në ketë drejtim se ende jemi në periudhën e tranzicionit nga koha e monizmit, nuk është fakt bindës, sepse koha prej një çerek shekulli ka qenë e mjaftueshme, për ndryshime cilësore dhe veprime praktike nga klasat politike të subjekteve udhëheqëse. Çdo refuzim për tu ballafaquar me realitetin paraqet dobësi organizative, kadrovike dhe mungesë e vullnetit politik, për avancim dhe zgjidhje të çështjeve kontestuese për shoqërinë në vendin përkatës. Pikërisht në këtë aspekt shumë çështje mund të njihen me mirë nga antropologjia politike, se sa nga fushat e tjera si sociologjia apo shkencat politike.

Nuk ka dilemë se për të shkruar një libër të tillë autorit i është dashur shumë punë, duke konsultuar një literaturë profesionale në gjuhë të huaja, sepse në shqip ajo pothuaj mungon tërësisht.

Dhe në fund e them pa hezitim se si i tillë ky libër duhet të jetë referencë e domosdoshme për studime dhe hulumtime në fushën e sociologjisë dhe të shkencave politike, sepse paraqet studimin me të kompletuar deri më tash në gjuhën shqipe (më 11.12.2016 u bë përurimi i 14 librave në Ulqin).

Mund të jemi më të zgjuar se dikush, por jo më të zgjuar se gjithkush (V.Goete).

Festa e Zojës së Këshillit të Mirë

Shkruan **don Gabriel Grabanica**

Një nga Festat në Kujtim të Luftës Heroike Shqiptare kundër Osmanëve, më 18.10.2017

Në Qytetin e Veriut të Shqipërisë, Shkodër, që prej kohëve të lashta nderohej me përkushtim të veçantë, është një figure e mrekullueshme e Zojës. Është ajo figure që sot ndodhet në Gjenacan të Italisë. Historia e saj, është vetë historia e katolicizmit ndër shqiptarë, katolicizëm i cili, me vdekjen e Gjergj Kastriotit, Skënderbeut, më 1468, nisi udhën e vet të kryqit. Ndërsa një pjesë e madhe e banorëve, gjatë pesë shekujve të robërisë, do të shtrëngohej të ndërronte fenë e një pjesë tjetër do të merrte rrugët e mërgimit, vetëm një pakicë do të mbetej besnike, duke vuajtur porsi gjarpri nën gur për shekuj e shekuj. E pikërisht në këtë kohë, rreth vitit 1467, kur një ushtri e re e madhe e sulltanit u dynd mbi Shkodër, sipas gojëdhënës, figura e Zojës u shkëput nga muri i Shenjtërores rrëzë Kështjellës së Rozafës, për të mos u dhunuar nga hordhitë anadollake. E mbartur nga engjëjt, mbështjellë prej një reje - vijon gojëdhëna - u ndalua në Gjenacan, afër Romës. Gojëdhëna tregon edhe se Figurën e mrekullueshme e përcollën dy shkodranë, rojtarë të shenjtërores, e ndërsa ecnin me sytë lart, pa u kujtuar as ata vetë, e kaluan në këmbë detin Adriatik. Si arritën në Romë, figura u zhduk nga sytë e tyre.





Por nuk vonoi e në të gjithë Italinë u hap zëri se një figure e mrekullueshme kishte zënë vend në muret e Shenjtërores së Gjenacanit, ku me ndërmjetësinë e saj po kryheshin mrekulli të panumërta. Ishte data 25 prill 1467.

Që asokohe nisën shtegtimet e besimtarëve drejt Gjenacanit, e Zoja jonë e Këshillit të Mirë, Pajtorja e shqiptarëve, nisi të nderohej edhe në Itali, Gjermani, Austri e më vonë edhe në kontinente të tjera, me të njëjtën figure, që vijon të nderohet në Gjenacan.

Kjo figurë, pra, nderohej në kishëzën dy herë të rrënuar të Zojës rrëzë Kështjellës Rozafa, një nga më të vjetrat në Shqipëri. Në këmbë apo gërmadhë, Kisha mbeti gjithnjë cak shtegtimi. Nuk ka besimtar që duke kaluar andej, edhe pas vitit 1967, kur kisha u rrënua për herë të dytë nga diktatura enveriane, të mos jetë lutur në heshtje për ditë më të mira me një lutje tradicionale, që i qëndroi kohës, më shumë se muret: "O Zoja e Bekueme, Nana e Këshillit të Mirë, po të thërrasim ty, që je Bija e zgjedhuna e Zotit Atë, Nana e Jezu Krishtit, Nusja e Shpirtit Shenjt, Tempull i së Shenjtnueshmes Trini: ndërmjetëso për ne në qiell!".

E kur Kisha u rindërtua, Lutja u pasurua me fjalët: "Ndër duert tua të fuqishme, o Nanë e Mëshirës, po e lëshojmë të dashtunin kombin tonë, me gjithë se jemi mëkatnorë të mjerë e të padenjë. Po të falënderojmë se na je gjetë e na ke ndihmue me kujdesin e një Nane të vërtetë në dimnin e gjatë e të vështirë të persekutimit, i cili na shkaktoi viktima të panjehuna, martirë që tash ndërmjetësojnë për ne në qiell. Po të falënderojmë që na e nxore nga Zoti hirin e rikthimit të pranverës së lirisë fetare e qytetare, e cila i hapë rrugën ndërtimit të një shoqnie ma të drejtë e ma vëllaznore".



Shqiptari mbetet Shqiptar

Shqiptarët kanë një ide
Nuk e ndërrojnë kombin me fe
Para thonë jena Shqiptar
E pastaj edhe fetar

Kombi këtu është autokton
Fenë edhe e ndrron
E ndrron kur do ti vetë
Shqipëtar mbetesh gjithmonë në jetë

Në Shqipëri ka disa fe
Por mbi të gjitha një atdhe
Një atdhe e një kombësi
E ka emrin Shqipëri


Me t'vërtetë asht mrekulli
Si ka qëndru kjo Shqipni
Asht çudi si ka shpëtu
Kjo Shqipëri pa u shkatrru

Megjithëse jemi të ndam
Në 5 shtete në Ballkan
Diçka asht që na bashkon
Asht Shqipnia që s'na harron

Shqipëtarët kudo që janë
Një simbol t'përbashkët kanë
Kanë flamurin kuq e zi
Që përfaqëson këtë Shqipni

Asht diçka që preferojmë
Komb e fe nuk i harrojmë
Pse nuk jena nji me fe
Jena vllazen për atdhe

E qiti* **Fadil Elez Popi-Kraja, Shkodër,
nga Arbneshi i Krajës
Majlinda Kraja <majlinda.kraja@yahoo.com>



Simboli i Eskulapit me gjarpër
Stipçeviqi* shkruan: "... edhe vetë emri i kësaj perëndie te grekët dhe romakët ka origjinë (prejardhje) ilire.

*Stipçeviq Aleksandër, Ilirët /historia, jeta, kultura, simbolet e kultit/ Botimet Toena, Tiranë 2002:309-22; Buzuku 34/2010:10; Buzuku 28/2008:3.



Përcjellja e dasmorëve më kangë në Braticë, Ulqin, më 1974; shumica e grave me veshje kombëtare shqyptare,

Nga Epi i Gilgameshit

Utnapishtimi i flet Gilgameshit*:
"Pushoje vajin, frenoje zemërimin!
Fate të ndryshme kanë hyjt e njerëzit
Baba e nëna t'pollën si njeri.
Ndon'se dy t'tretat hyjnore i ke,
të njerëzve e ke ti një të tretën,
që të tërheq ka fati i njeriut.
Amshimi s'është dhënë për njeriun!
Vdekja mizore është, cakton çdo fat".
**
Utnapishtim*, bir i Ubar Tutuit,
ndërtoje ti prej drurit një shtëpi,
ndërtoje në një bark. Le të humbas
krejt pasuria. Jetën ti kërkoje,
përbuze pronën, jetën ti shpëtoje.
Në barkë sill çdo lloj fare të jetës –
e gjatë dhe e gjerë njësoj të jetë.
Ti sa më parë barkën ta ndërtosh
e fute n'detin me ujë të ëmbël,
dhe sa më mirë me çati mbuloje!
Mirë e kuptova hyjin dhe i thashë:
"Do të punoj, im zot, çka të me thuash,
me nder do ta përmbush urdhrin tënd.
Mirëpo unë, çka do t'i them qytetit,
polemit si dhe pleqve më të vjetër?"
Gojën e hapi Ea dhe me tha,
mua shërbëtorit t'vet: "O bir njeriu
atyre u thuaj: 'Zoti i madh, Beli,
m'shikon me smirë dhe prandaj nuk dua
të jem banues i qytetit tuaj,
tokën e Belit nuk dua ta shoh.
Dua të shkoj në det me ujë t'ëmbël,
t'banoj te Ea, zot që mëshiron,
dhe ju do t'ju bekoj me t'gjitha t'mirat'.
Porsa shkëlqeu agimi i mëngjesit
të gjitha gjërat nisa t'i bëj gati
dhe shkova der' te deti me uj' t'ëmbël.
Gjeta aty rrëshirë, gjeta drurë,
planin e bakës e bëra at'botë.
Gjith' farefisi, t'fortë dhe të ligj,
shpërvolën duart, punës iu përveshën.
N'muaj t'Shamashit barka u ndërtua.
Çdo gjë që pata në të e ngarkova –
në të ngarkova argjend edhe ar
dhe farën e secilit lloj të jetës;
familjen time, farefisin t'afërt,
në barkë t'gjithë aherë i vendosa;
gjedhe t'mëdha si dhe kafshë të vogla
aty i solla, si dhe zanatlinj
të çdo mjeshtërie i lash' brenda të hyjnë.

**Nga* Epi i Gilgameshit, Rilindja, Prishtinë 1984: (kënga e dhjetë) 91-2&94. E përktheu Anton Berisha prej gjermanishtes. Ky ep është i traditës letrare sumero-babilonase i moçëm rreth 4 mijë vite.

Prenkë Jakova

MARAKUN Ç'E TRETA I MJERI

Kam pasë dashtë nji shestaneshë
Gja ma t'bukur s'kisha ndeshë,
Faqekuqe e hollë si hala,
Veshë e mbathë si dielli e hana,
Gja ma t'bukur s'ka ba nana,
Porsi molla e Misirit,
Gja ma't bukur ftyra nirit,
Por për mue s'kishte kenë,
Unë i “bull” ajo e kshtenë,
Thash njiher po shkoi dhe e bie,
E n'tan Shkodren e baj beli,
Tash thonë Heti ka humbë mend
Për kët punë nuk po d'vetë kend,
N'tan pazarin t'ash m'del kanga,
Krejt pa mend tash m'beten nana,
Për terzi tash m'merret ana,
Ma mirë syni, sesa nami
Hiqi Hetë men't nga Shestani,
Qysh n'at dasëm në Ostros,
Bejta Hetit nuk u sos.
Për Shestanin Shestaneshën,
Për syzezën stamolleshen
- Ah medet si paska qenë,
Mos me t'gushë se je e kshtenë
Por sa herë që vjen prandvera
Prej Shestanit tash m'frynë era,
Tue ndie eren n'çardak,
Do t'kujtoj t'shkretin marak,
Tue fry blini t'kujoj ty,
Tue t'puthë gushë e tue t'puthë sy
Kur t'shkojnë sulet për Ostros,
Thueji Lules mos qit lot,
Kur t'shkojnë barkat për Tivarë
Thoni Lules u bafsh me djalë
Tash që dole n'Dobrovodë,
Tash të fusin n'tjetër odë,
Tash ta qes kangen me shokë.
....
Për njikshtu si ja kam nisë,
Nja dy kangë kam me ti qitë,
T'i knoj unë me Oso Fallin,
Gjergji Macit t'a qanë hallin,
Me lot n'sy tash t'kujon Heti,
Diq maraku m'u fik derti,
Tash kërkoj unë nuse njeti.
....
Porsi flutur n'pazar t' Shkodrës
Shestaneshë moj shestaneshë,
Si zamaku që çilë n'prandverë
Porsi lule qenke veshë..

Shoqata Shestani face book
(27 June 1917 – 19 September 1969)

Gjergj Fishta thotë:
“Vërtetë na kemi Bajram e Pashkë, por Shqyptarinë e kemi bashkë”.

Donatorët për Kishën e Braticës

1.Nika i Kol's Sim's Gjonit Simonoviq - donacion material mermer dhe montim. Në mungesë të shumës në vlerë monetare, ne e falënderojmë për një kontribut shumë te çmuar, por në të ardhme do ta japim edhe shumën monetare.
2.Dalibori i Nik's Kol'Nik's Simonoviq, i cili ka bërë montimin e qendrës për rrymë, edhe ky me një vlerë të mirë, si materiale po ashtu edhe punë fizike në montimin e tij.
3.Simo Marnikoviq material ndërtimor dhe punë fizike, vlera 400.
4.Gjergji i Lek's Dediq - 300 euro instalimin e rrymes në Kishë
5.Pala i Jozit Jankoviq - donacion mermer në vlerë 1400 euro.

Ndihmuan revistën BUZUKU 49

(Renditja si mbas abecedës)
Anrija Lorit Palës Macit-Marnikoviq (Marnikonj), Bishti Malit, Ulqin-€50.
Cafo Boga, Amull, Ana e Malit, Ulqin, tash në Nju Jork-€150.
Don Gabriel Grabanica, Kisha në Braticë-€250.
Gjoka Nikës Stjepës-Niloviq (Nilonj), Braticë, Ulqin, tash në Zvicër-€100.
Lekë Simë Gjon Dobreci, Braticë, Ulqin, tash n'Vakuver, Kanada-€100
Nikë Palkola, Kllezën, Ulqin, tash n'Nju Jork, Amerikë, USA-€50.
Pjetri Zefit Gjonit Niksë-Dobreci, Totosh, Ulqin-€50.
Preçi Sim's Jakut Simonit Nik's-Junku, Shtoj, Ulqin, tash Dorchester,MA,USA-$100.
Shitja-110€.
Redaksia ju falet nderit. Qofshi gjithmonë faqe bardhë

Monedha vërteton - Odiseu ishte ILIR

Kryet e Odiseut në monedhë metalike nga Itaka paraqitet i mbuluar me qeleshe (plis), shekulli i tretë para Krishtit /Head of Odysseus wearing a pileus depicted on a 3rd-century BC coin from Ithaca/.



Për kësulën te **ILIRËT** Stipçeviqi* **thotë: ”në esencë nuk dallohet shumë nga kapela (kësula) e bardhë e sotme shqiptare, qeleshja”**. Sot është e sigurte që ilirët janë të parët e shqyptarëve.

*Stipçeviq Aleksandër, Ilirët /historia, jeta, kultura, simbolet e kultit/ Botimet Toena, Tiranë 2002:89 (Buzuku 34/2010:9).
*Dobreci Simë, Krijime Popullore Shestanase, Diti&Oli, Ulqin, 2017:245.
https://upload.wikipedia.org/wikipedia/commons/9/92/Odysseus_-01.jpg
Përshëndetje **Gazmend Çitaku** gazi <gazi@t-com.me> Za: Buzuku <fdobreci@t-com.me> Datum: 16.11.2017 13:16

Visar i trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore

Ulqin – Qendra e Kulturës, respektivisht Biblioteka e Ulqinit, Shtëpia Botuese "Ulqini" dhe Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi organizuan të premten mbrëma më 28.07.2017, në sallën e mbushur plot të Bibliotekës së Qytetit përurimin e librit "Krijime popullore shestanase", i përgatitur nga prof. dr. Simë Gjon Dobreci.



Moderatorja e përurimit, Ardita Rama, udhëheqëse e Bibliotekës së Ulqinit, ka thënë se kemi të bëjmë me një përurim pak të pazakontë, pasi që autori është me profesion mjek, kurse libri s'ka të bëjë fare me mjekësinë.

"Vetë prof. dr. Simë Dobreci është një person i pazakontë, një humanist, intelektual i shquar e dijetar i përmasave kombëtare", ka thënë ajo.

Për librin ka folur mësimdhënësi Ali Gjeçbritaj, i cili e ka vlerësuar atë "visar të trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore".

"Krijime popullore shestanase është një thesar i çmuar i trashëgimisë kulturore, gjuhësore, një begati e konsiderueshme e traditës së një popullate që për fat të keq është shpërndarë gjithandej nëpër botë, është edhe tjetërsuar në një farë mënyre një pjesë e tij", është shprehur ai.

Sipas tij, autori Dobreci ka qenë mjaft i kujdesshëm gjatë punës për grumbullimin e materialit në terren.

"Kjo shihet edhe në secilën këngë ku pothuaj pjesa më e madhe e tyre janë në disa variante", ka theksuar Gjeçbritaj.

Dom Gabriel Grabanica ka thënë se ai është një nxënës i cili po mëson ditadités nga jeta, veprat dhe shkrimet e prof. dr. Simë Dobrecit.

"Unë e kam kryer një universitet, por universiteti i dytë është profesor Simë Dobreci", ka thënë ai.

Ndërsa për librin "Krijime popullore shestanase" ka thënë se është një kryevepër dhe enciklopedi.

"Çdo numër i ri i revistës 'Buzuku' është një enciklopedi në miniaturë, kurse kjo është një enciklopedi e mirëfilltë", është shprehur Grabanica.

Botuesi Gazmend Çitaku, pronar i Shtëpisë Botuese "Ulqini", ka folur për veprimtarinë botuese të tij, duke thënë se deri tani kjo shtëpi botuese ka botuar rreth 60 tituj, përfshirë librin "Krijime popullore shestanase".

Vetë prof. dr. Simë Gjon Dobreci, në fjalën e tij, ka falënderuar të gjithë që e kanë nxitur dhe mbështetur në përgatitjen dhe botimin e librit.

Në emër të organizatorit ka përshëndetur kryetari i Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë në Malin e Zi, prim. Dr. Gani Karamanaga, si dhe Safet Kurtagiq, drejtor i Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave, që e ka mbështetur botimin e librit.

Në përurim janë lexuar edhe vështrimet e redaktorit të librit, dr. Rrustem Berisha, dhe recensentëve prof. dr. Emil Lafe dhe prof. dr. Hajrullah Koliqi.

Këngë nga libri kanë lexuar aktori Shefqet Luca dhe Zana Dobreci, kurse Jozo Jakoviq, pedagog, dhe Simo Simonoviq, nxënës i Shkollës së Muzikës në Ulqin, kanë luajtur pjesë në fizarmonikë.

Prof. dr. Simë Gjon Dobreci ka punuar në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, ku ka ligjëruar lëndën e dermatologjisë. Është autor i disa librave nga fusha e sëmundjeve të lëkurës. Ka qenë kryeredaktor i revistës profesionale-shkencore të Shoqatës së Mjekëve të Kosovës "Praxis Medica", kurse tani drejton revistën "Gjon Buzuku".

Përveç shumë shpërblimeve të tjera për veprimtaritë e veta, Simë Dobreci është dekoruar me "Medaljen Presidenciale të Meritave" nga Presidenti i Kosovës në vitin 2016 dhe Urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Shqipërisë në vitin 2017.

Marrë nga **KOHA JAVORE** nr 775, 3 gusht 2017:16



Vepër e rëndësishme për letërsinë gojore shqiptare

Shkruan **Gjekë Gjonaj**



Dermatologu i njohur prof. dr. Simë Gjon Dobreci lexuesit shqiptar i dhuroi librin ”**Krijime popullore shestanase**”. Autori, edhe pse me profesion mjek, u fut në historinë e folkloristikës me një njohuri teorike modeste, por me pikëpamje të drejta rreth karakterit të mirëfilltë që duhej të kishin krijimet popullore. Me këtë libër dr. Dobreci u radhit ndër mbledhësit e hershëm të folklorit shqiptar të cilët u nxitën nga Romantizmi Evropian për të vlerësuar trashëgiminë folklorike dhe sidomos trashëgiminë e këngës popullore.

Libri “Krijime popullore shestanase” të autorit dr. Simë Gjon Dobrecit është një produkt i vullnetit të tij të kahmotshëm për grumbullimin e thesarit të pasur popullor të shestanasve. Autori i librit është rritur e brumosur me përdorimin e prozës tregimtare popullore të Shestanit, një nga zonat etnike të shqiptarëve në Malin e Zi, saqë kureshtja dhe vullneti e tij i madh kanë bërë të mundshëm formimin, përdorimin dhe shënimin e këtij thesari folklorik, nga i cili bindemi se tradita folkloristike, si një dhunti e natyrës psikoetnike, është mjaft e pasur dhe e pashtershme.

Autori shkruan në hyrje të librit se “krijimtaria popullore e Shestanit më ka gëzuar dhe entuziasmuar. Botimi i saj në revistën BUZUKU, si dhe disa miq më dhanë idenë dhe më shtuan dëshirën që t'i bashkoj në një libër të vetme, ashtu që të lexohen më lehtë. E bëra këtë punë me dashuri, sepse kjo është pasuri e çmueshme që na e lanë të parët tonë”.

Materiali i bletës shestanase në këtë libër është renditur sipas gjinive. Libri përfshinë pjesë me këngë dashurie, këngë dasme, kurbeti, balada e elegji, vajtime, këngë humoristike, këngë kreshnike, të barinjve e krijime të tjera nga letërsia gojore e Shestanit të botuara në revistën “Buzuku”, sikurse edhe për disa shestanas të njohur.

Dr. Sima këto materiale të mbledhura të folklorit i ka regjistruar ashtu siç jetonin këto thesare në përvojën aktuale popullore, pa bërë përpunime e shtesa të tyre me ngjarje që nuk i kishin tekstet origjinale. Qëllimi i tij kryesor ishte objektiv: T'u siguronte shestanasve një identitet kombëtar, për të forcuar dhe bashkuar kombin gjuhësisht dhe kulturalisht. Synimi tjetër i tij ishte të regjistronte krijimtarinë folklorike të kësaj trevë folklorike dhe për të rritur e ndërgjegjësuar atë, po dhe për ta ruajtur gjatë në kujtesë.

Urtësia popullore shestanase e trajtuar në këtë libër është jo vetëm dëshmi e trashëgimisë së pasur shpirtërore, por edhe e dashurisë ndaj njerëzve dhe ndaj vendlindjes. Aty është përdorur një sistem i ngopur dhe i pasur i të shprehurit poetik, janë gërshetuar krahasime dhe metafora, të cilat të njësuara e të ndërlidhura mes veti, funksionalizohen mjeshtërisht në tërësinë kuptimore dhe shprehëse artistike të krijimeve përkatëse.

Ka rëndësi të përmendet fakti se dr. Sima nuk nisi t'i mbledhë këto këngë si talent dhe pastaj të zbulonte vlerat e larta të atyre këngëve, por ai e nisi këtë punë me një qëllim të caktuar patriotik, i shtyrë nga dashuria e vendit dhe e gjuhës. Punoi në mënyrë autodidakte, pra ai nuk vinte nga ndonjë formim etnologjik dhe folklorik, por duke qenë përpara kësaj situate të habit fakti që vepra ka një karakter të pranueshëm shkencor.

Këto krijime gojore, epike, lirike, epiko-lirike, të cilat janë ruajtur e zhvilluar që nga kohët e hershme e deri në ditët e sotme, në saj të kujdesit të përgjithshëm të shestanasve, paraqesin një vlerë për mbarë folkloristikën tonë. Ato përbëjnë një trashëgimi të vyer po edhe të pastudiuar sa e si duhet nga gjuhësia dhe folkloristika shqiptare. Prandaj, botimin e kësaj krijimtarie popullore e konsideroj si një vepër të rëndësishme për letërsinë gojore shqiptare, si një pasuri të përgjithshme kombëtare.



Botuar edhe në KOHA JAVORE 777, 17 gusht 2017:14-5.

Gruaja e fisit të Shestanit*

Sipër fotografisë shkruan:

Në Mal të Zi, në rrethin e Tivarit dhe Ulqinit, gratë e fisit të Shestanit e mbulojnë kryet me shami të madhe të bardhë. Flokët mbi ballë të krehur e të ndarë në dy bishtaleca krijojnë një kurorë me dredhë të paktë sipër majës së kresë. Mbi këtë kurorë të flokëve qëndron shamia e madhe e bardhë, rëndomtë e dhëmbëzuar në skaje. Me rrudha të veta të përshtatshme kjo shami (bashbez) bie në krahët e shpinë, kurse mbi ballë jep përshtypjen e qartë të diademës së bardhë, çka të gjithë këto i japin një kornizë të posaçme. Ky model i mbulimit të kokës së shestaneshave të përkujton stilizimin e qartë gotik[1]. Në përgjithësi mbizotëron tegeli zbukurues i shamisë së bardhë, e cila edhe sot i ka dhëmbëzat po ashtu të mëdha; kësula këto që i shohim në formë të njëjtë në oltarët e Dubrovnikut, me fragmente të mbulesave të moçme.

**Marrë prej* prof. Marijana Gušić: Etnografski elementi u razvoju našeg primorja, POMORSKI ZBORNIK, Zagreb 1962:611. *Shih* Buzuku 3, 2001:14.

**

Stipçeviqi[1] shkruan "..**femrat ilire i kanë mbajtur shamitë edhe shumë më të mëdha ... të bëra nga materiali i bardhë, të cilat përveç kokës mbulonin edhe shpinën.**

Nga **kësulat të cilat i mbanin ilirët,** njohim katër lloje të ndryshme. Ka qenë i shpeshtë tipi i kapelës me formë të rrumbullakët që është paraqitur në monumentin nga Zenica, që **në esencë nuk dallohet shumë nga kapela (kësula) e bardhë e sotme shqiptare, qeleshja**. Në përgjithësi mendohet, me të drejtë, se kësula e sotme shqiptare drejtpërdrejt buron nga kësula e ngjashme që e mbanin ilirët".

Pra, veshja e bardhë mbizotëronte te ILIRËT, prej të cilëve e trashëguan edhe krajanët me shestanasit.

1. Stipçeviq Aleksandër, Ilirët /historia, jeta, kultura, simbolet e kultit/ Botimet Toena, Tiranë 2002:92&89 (Buzuku 34/2010:23; Buzuku 34/2010:9).

U Crnogorskom primorju, u zaleđu Bara i Ulcinja, žene iz plemena Šestana pokrivaju glavu velikom bijelom maramom. Kosa začešljana nad čelom na razdjeljak podignuta je u pletenicama i čini kao neki vijenac s neznatno svedenim lukom na tjemenu. Na taj vijenac od kose obavija se velika bijela marama, obično nazupčana na kraju. Svojim skladnim naborima ova marama pada na ramena i na pleća, a nad čelom svedena je u obliku bijelog čistog dijadema što sve daje ovom oglavlju osobit okvir. Ovako oblikovano oglavlje šestanskih žena odaje izrazito gotičku stilizaciju. U svemu ističe se ukrasni porub bijele marame, koja i danas ima onakve velike zupce – kapice kako to vidimo u istom formatu na dobrotskim oltarnicima. fragmentima starinskih pokrivača.



Žena iz plemena Šestana

Marrë nga prof. Marijana Gushiq
Etnografski elementi u razvoju našeg primorja. Në:
POMORSKI ZBORNIK, Zagreb 1962: 611

Janullatos'i n'Shqipëri i huej e armiqsor

Shkruan **Agim Gashi***



Shqiptari është vetëm shqiptar
Ai nuk blihet në markete e as në Pazar,
Ti o je i huaj, mysafir në tokën tonë
Ose je i bimë nga toka dhe je shqiptar.

Njeriu që gjithmonë profesion e kishte spiunazhin dhe tradhtinë, është ky njeri me mjekër si të çetnikut Drazha Mihajlloviq. Njeri më të dëmshëm se ky person që gjithmonë ishte në shërbim të shovinizmit grek, nuk ka në tokat tona. Pse erdhi e kush e solli? A nuk u mësuan shqiptarët akoma se deri sot të huajt e lindjes, dhe të fqinjët grek, gjithmonë na sollën vetëm dëme e përçarje ndërvëllazërore, ndërfetare e ndërnjerëzore?

Veladoni i priftit në gjoksin këtij shovinisti grek, s'mund të ia fsheh e as të ia maskoj punën e ndyrë që bën në atdheun tonë. Puna e tij dhe bindjet e tij e prunë edhe Kryepeshkopin serb në Shqipëri i cili me „bekimin" e tij, midis të Shqipërisë tha se:-Kosova e Metohija është tokë serbe!

Më vonë me „bekimin" e tij grupe çetnikësh serb shpalosen flamurin serb duke ngritë tre gishtërinj midis Tirane. Me „bekimin" e tij edhe Edi Rama i dha çelësin Bregoviqit, ftuan Zdravko Çoliqin të çirret në televizionet tona dhe me bekimin e tij Shqipëria merr teposhtën çdo ditë e çdo minut.

Binduni se ky mjekrosh në çdo mëngjes kur zgjohet nga gjumi, mallkon popullin tonë dhe atdheun tonë. Largojeni më shpejt sa nuk ia kini pa sherrin më të madh. Dikur do të bëhet vonë.

Çdo ditë e qëndrimit të tij në Shqipëri, është poshtërim për Nolin, për Kishën Autoqefale Shqiptare, për At Nikollë Markun, për kombin e për atdheun!

Berisha pruni edhe grekun antishqiptar Janullatosin për kryeipeshkëv të kishës ortodokse shqiptare.

*Agim Gashi <sharkia_323@hotmail.com>; Düren, Gjermani, 18.06.2014.